




Efekti i të lexuarit në mirëqenien psikologjike dhe inteligjencën emocionale të fëmijëve të Kosovës



Gusht, 2020

Efeki i të lexuarit në mirëqenien psikologjike dhe inteligjencën emocionale të fëmijëve të Kosovës

Autorë & hulumtues:

Diar Hajrizi, Drenusha Bujari, Fatime Rrahmani, Shkurtë Bajgora & Zoran Stankovic

Shqyrtues të brendshëm:

Besnik Peci & Liridona Sijarina

Dizajner grafik:

Diar Hajrizi

Botues:

ETEA, QHPSM & CSAY

Përkrahur nga:

European Union Kosovo

Forumi per Iniciativa Qytetare (FIQ)

Institute for Development Policy (INDEP)

Komuna e Prishtinës

Translation Centre

Smart Center

Përmbajtja e raportit hulumtues “Efeki i të lexuarit në inteligjencën emocionale dhe mirëqenien psikologjike të fëmijëve të Kosovës” është përgjegjësi e organizatave ETEA, Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore (QHPSM) dhe Qendra për Afirmimin Social të të Rinjve (CSAY) dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet qëndrimet e donatorëve.

Gusht, 2020

E drejta e autorit © 2020: ETEA, QHPSM & CSAY

Të gjitha të drejtat e rezervuara bazuar në Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Përveç citimit të fragmenteve të shkurtra, pjesët e këtij raporti hulumtues nuk mund të riprodhohen apo transmetohen në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjet elektronik, mekanik, fotokopjohen dhe inçizohen pa lejen paraprake të ETEA-s, QHPSM-së dhe CSAY-së.

Përmbajtja

Lista e grafikoneve.....	6
Lista e tabelave	8
Lista e akronimeve & shpjegimeve.....	9
Të gjeturat kryesore	12
Hyrje	18
Leximi.....	18
Leximi dhe mirëqenia psikologjike	21
Leximi dhe inteligjenca emocionale	24
Leximi në Kosovë.....	26
Qëllimi i hulumtimit.....	27
Metodologjia.....	30
Lloji i studimit.....	30
Mostra	30
Procedura.....	34
Instrumentet	34
Strategjia Analizuese	36
Rezultatet.....	40
Rezultatet sasiore	40
Llojet e motivimit, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale	40
Zhanret e librave, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale	41
Dallimet gjinore në mirëqenien psikologjike & inteligjencën emocionale	43
Regjistrimi në bibliotekë, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale	43
Leximi i librave jashtë-kurrikular, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale	45
Hera e fundit e leximit, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale	46
Numri i librave të lexuara në vit, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale	49
Pëlqyeshmëria e leximit, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale.....	50

Të lexuarit aktiv, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale	52
Biseda me familjarët për libra, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale	53
Rezultatet cilësore	57
Kategoria 1: Lexueshmëria si fenomen.....	57
Kategoria 2: Dallimet gjinore në të lexuar dhe shkaqet për këto dallime	57
Kategoria 3: Ndërlidhja në mes të lexuarit dhe mirëqenies psikologjike	58
Kategoria 4: Mekanizmat e ndikimit pozitiv që të lexuarit ka në mirëqenien psikologjike	59
Kategoria 5: Konteksti familjar si motivues apo demotivues për të lexuar	59
Kategoria 6: Angazhimi mental i fëmijëve gjatë leximit. A lexojnë fëmijët në mënyrë pasive apo aktive?.....	60
Kategoria 7: Inteligjenca emocionale dhe rëndësia e saj në kontekstin shkollor	61
Kategoria 8: Biblioterapia si mjet për të reduktuar problemet emocionale.....	61
Kategoria 9: Rekomandime për ngritjen e vetëdijes mbi përfitimet e të lexuarit	62
Diskutimi	65
Limitimet.....	68
Rekomandimet.....	72
Rekomandime për institucione & shkolla	72
Rekomandime për organizata jo-qeveritare	73
Rekomandime për familje.....	73
Referencat.....	76
Mirënjohje	80

Lista e grafikoneve

<i>Fig.1. Shpërndarja gjinore e pjesëmarrësve.....</i>	<i>31</i>
<i>Fig.2. Moshë e pjesëmarrësve.....</i>	<i>31</i>
<i>Fig.3. Klasa në të cilën pjesëmarrësit bëjnë pjesë.....</i>	<i>31</i>
<i>Fig.4. Vendbanimi i pjesëmarrësve.....</i>	<i>31</i>
<i>Fig.5. Komuna e pjesëmarrësve.....</i>	<i>32</i>
<i>Fig.6. Shkolla e pjesëmarrësve.....</i>	<i>33</i>
<i>Fig.7. Faktorët motivues që shtyjnë fëmijët të lexojnë dhe mesatarja e mirëqenies së tyre psikologjike.....</i>	<i>40</i>
<i>Fig.8. Faktorët motivues që shtyjnë fëmijët të lexojnë dhe mesatarja e inteligjencës së tyre emocionale.....</i>	<i>41</i>
<i>Fig.9. Zhanret e preferuara të librave dhe mesatarja e mirëqenies psikologjike të fëmijëve.....</i>	<i>42</i>
<i>Fig.10. Zhanret e preferuara të librave dhe mesatarja e inteligjencës emocionale të fëmijëve.....</i>	<i>42</i>
<i>Fig.11. Mirëqenia psikologjike e fëmijëve që kanë listuar 0, 1, 2 apo 3 libra jashtë-kurrikular që i kanë lexuar së fundmi.....</i>	<i>45</i>
<i>Fig.12. Inteligjenca emocionale e fëmijëve që kanë listuar 0, 1, 2 apo 3 libra jashtë-kurrikular që i kanë lexuar së fundmi.....</i>	<i>46</i>
<i>Fig.13. Mirëqenia psikologjike e fëmijëve që kanë lexuar ndonjë libër në muajin e fundit, në gjashtë muajt e fundit, në 12 muajt e fundit, dhe atyre që nuk iu kujtohet hera e fundit.....</i>	<i>47</i>

<i>Fig.14. Inteligjenca emocionale e fëmijëve që kanë lexuar ndonjë libër në muajin e fundit, në gjashtë muajt e fundit, në 12 muajt e fundit, dhe atyre që nuk iu kujtohet hera e fundit.....</i>	<i>48</i>
<i>Fig.15. Mirëqenia psikologjike e fëmijëve në varësi të numrit të librave që lexojnë në vit.....</i>	<i>49</i>
<i>Fig.16. Inteligjenca emocionale e fëmijëve në varësi të numrit të librave që lexojnë në vit.....</i>	<i>50</i>
<i>Fig 17. Trendi i ngritjes së mirëqenies psikologjike me ngritjen e pëlqyeshmërisë së të lexuarit.....</i>	<i>51</i>
<i>Fig 18. Trendi i ngritjes së inteligjencës emocionale me ngritjen e pëlqyeshmërisë së të lexuarit.....</i>	<i>52</i>
<i>Fig 19. Trendi i ngritjes së mirëqenies psikologjike me ngritjen e të lexuarit aktiv.....</i>	<i>53</i>
<i>Fig 20. Trendi i ngritjes së inteligjencës emocionale me ngritjen e të lexuarit aktiv.....</i>	<i>53</i>
<i>Fig 21. Trendi i ngritjes së mirëqenies psikologjike me ngritjen e të bisedës me familjarët për libra</i>	<i>54</i>
<i>Fig 22. Trendi i ngritjes së inteligjencës emocionale me ngritjen e të bisedës me familjarët për libra.....</i>	<i>55</i>
<i>Fig.23. Graf përmbledhës i të gjitha analizave konkluduese të performuara në këtë studim. Shënim: vijat e ndërprera nënkuptojnë rezultate jo-signifikante.....</i>	<i>56</i>

Lista e tabelave

Tabela.1. Analiza e t-test për të gjetur a ka dallime gjinore në MP dhe IE tek nxënësit e Kosovës.....43

Tabela.2. Analiza e t-test për të gjetur se a ka dallime në MP dhe IE në mes të fëmijëve që janë të regjistruar në bibliotekën e shkollës dhe atyre që nuk janë.....44

Tabela.3. Analiza e t-test për të gjetur se a ka dallime në MP dhe IE në mes të fëmijëve që janë të regjistruar në bibliotekën e qytetit dhe atyre që nuk janë.....44

Lista e akronimeve & shpjegimeve

MP:

Mirëqenia Psikologjike

IE:

Inteligjenca Emocionale

M:

Mesatarja

DS:

Devijimi Standard

Biblioterapia:

Përdorimi i librave si terapi për të trajtuar shqetësime psikologjike

Alfa (α) e Cronbach:

Alfa e Cronbach është një matje e konsistencës së brendshme të një pyetësi, dhe tregon se sa të lidhura janë ndërmjet vete një grup deklaratash/pyetjeve të atij pyetësi

t-test:

t-test është një model statistikor që përdoret për të përcaktuar nëse ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të mesatareve të dy grupeve

ANOVA:

Analiza e variancës (Analysis of variance - ANOVA) është një model statistikor që përdoret për të përcaktuar nëse ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të mesatareve të tre ose më shumë grupeve

Regresioni linear:

Një model statistikor përmes të cilit ne mund të parashikojmë pikët në një variabël nga pikët në një variabël tjetër

p:

Vlera p është probabiliteti që rezultatet e observuara janë arritur rastësisht. Kjo gjasë duhet të jetë më e vogël se 5% ($p < 0.05$) që rezultatet të konsiderohen statistikisht të rëndësishme

η^2 :

Madhësia e efektit, që tregon se sa është i fortë efekti i një variable në një variabël tjetër



Të gjeturat kryesore



Të gjeturat kryesore

- Fëmijët që kanë deklaruar se lexojnë sepse e shijojnë të lexuarit, pra kanë motivim të brendshëm, kanë raportuar mirëqenie psikologjike më të lartë në krahasim me grupet tjera, sidomos në krahasim me ata që kanë deklaruar se asgjë nuk i motivon të lexojnë
- Fëmijët që kanë deklaruar se lexojnë për shkak të relaksimit që përjetojnë gjatë leximit; të nevojës për të marrë informacion; dhe për shkak të rekomandimeve nga shoqëria, kanë raportuar inteligjencë emocionale dukshëm më të lartë në krahasim me fëmijët që kanë deklaruar se asgjë nuk i motivon të lexojnë
- Fëmijët që janë të regjistruar në bibliotekën e shkollës kanë raportuar inteligjencë emocionale më të lartë sesa ata që nuk janë të regjistruar; ndërsa ata që janë të regjistruar në bibliotekën e qytetit kanë raportuar mirëqenie psikologjike dhe inteligjencë emocionale më të lartë sesa ata që nuk janë të regjistruar
- Fëmijët që kanë qenë të aftë të listojnë tre, dy apo të paktën një libër jashtë-kurrikular që e kanë lexuar së fundmi kanë raportuar mirëqenie psikologjike dhe inteligjencë emocionale më të lartë sesa ata që nuk kanë listuar as një libër
- Nxënësit që kanë lexuar një libër në muajin e fundit, në gjashtë muajt e fundit apo në 12 muajt e fundit, shënuan pikë më të larta të mirëqenies psikologjike dhe inteligjencës emocionale sesa ata të cilët nuk mund ta kujtojnë herën e fundit që kanë lexuar ndonjë libër

- Nxënësit që lexojnë 5 deri në 16+ libra në vit raportuan mirëqenie psikologjike dhe inteligjencë emocionale më të lartë sesa fëmijët që lexojnë një deri në katër libra, dhe MP dhe IE ende më të lartë sesa ata që nuk lexojnë as një libër
- Pëlqyeshmëria më e madhe e procesit të të lexuarit nga ana e fëmijëve ka efekt në mirëqenien psikologjike dhe inteligjencën e tyre emocionale
- Të lexuarit aktiv (të qenurit i/e angazhuar mentalisht gjatë procesit të leximit) më i lartë parashikon mirëqenie psikologjike dhe inteligjencë emocionale më të lartë
- Biseda lidhur me librat në mes të fëmijëve dhe familjarëve të tyre ka efekt në mirëqenien psikologjike dhe inteligjencën emocionale të fëmijëve
- Psikologët e intervistuar mendojnë se vajzat lexojnë më shumë se djemtë dhe se janë më të zellshme në procesin e të lexuarit, gjë që mbështetet edhe në hulumtimet lidhur me dallimet gjinore në qëndrimet dhe motivimin për të lexuar (Durik et al., 2006; Pecjak & Peklaj, 2006; Smith & Wilhelm, 2002)
- Psikologët shkollorë pjesëmarrës në hulumtim listuan një mori përfitimesh të të lexuarit: zhvillimi i aftësive sociale me bashkëmoshatarë; zhvillimi i stabilitetit emocional; përmirësimi i raporteve me kolegë dhe prindër; ulja e sjelljeve anti-sociale; njohja më e thellë e vetes dhe kanalizimi më i duhur i aspiratave; përmirësimi i aftësive për zgjidhjen e problemeve; rritja e stabilitetit emocional si dhe zvogëlimi i stresit, ankthit, e tensionit, etj.
- Të intervistuarit ishin të mendimit se prindërit përmes modelimit dhe ofrimit të kushteve të përshtatshme duhet të mundësojnë zhvillimin e kulturës së leximit tek fëmijët

- Shumica e psikologëve të intervistuar u pajtuan se fëmijët janë mjaft pasivë, pra jo të angazhuar mentalisht, gjatë procesit të leximit; ata cituan mësimdhënësit si bartës së përgjegjesisë kryesore për këtë fenomen
- Një numër i vogël i psikologëve të intervistuar raportuan se e kanë përdorur librin si mjet terapeutik/këshillues për të ulur shqetësimet e nxënësve; megjithkëtë, të gjithë u pajtuan se biblioterapia në shkolla do të ishte një praktikë shumë e qëlluar

Hyrje



Hyrje

Raporti në vijim është përpiluar në kuadër të projektit "Ndikimi i leximit aktiv në shëndetin mendor të fëmijëve". Ky raport shpalosë të dhënat sasiore të cilat janë mbledhur përmes anketimit elektronik me nxënës të shkollave të mesme të ulëta në 20 komuna dhe 68 shkolla të Kosovës, si dhe të dhëna cilësore të mbledhura përmes intervistave të realizuara me psikologë shkollorë në Kosovë. Hulumtimi është realizuar nga organizata jo-qeveritare ETEA, Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore (QHPSM) dhe Qendra për Afirmim Social të Rinjve (CSAY), mbështetur nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe INDEP me burim financiar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Po ashtu, ky hulumtim është përkrahur edhe nga Komuna e Prishtinës, Translation Centere dhe Smart Center. Hulumtimi synon të kuptojë se çfarë efekti ka të lexuarit në mirëqenien psikologjike dhe inteligjencën emocionale të fëmijëve, krahas studimit të variablave tjera që janë të prezantuara në vijim.

Leximi

Të lexuarit është një nga aftësitë bazë të zhvillimit kognitiv apo njohës të njerëzve, të cilat mundësojnë më pas zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të tjera në fazat e mëvonshme të jetës. Të gjitha tregimet, fabulat dhe romanet realisht i ndihmojnë fëmijët të zhvillohen, të njohin botën dhe veten, të bëhen të sukseshëm në shkollë dhe në dimensionet e tjera jetësore. Në një ndër studimet e realizuara për të parë ndikimin apo rolin e leximit, ka gjetur se leximi ka efekt mjaft pozitiv tek fëmijët; duke ushqyer rritjen dhe zhvillimin e personalitetit, rritë aftësitë kognitive si dhe

Të lexuarit është një nga aftësitë bazë të zhvillimit kognitiv apo njohës të njerëzve, të cilat mundësojnë më pas zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të tjera në fazat e mëvonshme të jetës.

aftësitë shoqërore të fëmijës duke i ndihmuar ata të zhvillojnë edhe inteligjencën emocionale dhe krijmtarinë (Schiller, 2009). Në terma të matshëm, shprehinë e leximit shpesh konsiderohen për sa i përket sasisë së materialeve që lexohen, shpeshhtësisë së leximit, si dhe kohës mesatare të shpenzuar për lexim (Chettri & Rout, 2013), dhe kjo shprehë mund të të kultivohet tutje, që të jetë më i qëndrueshëm në faza të mëvonshme të jetës. Në një studim nga Cox dhe Guthrie (2001) tregon se leximi i pavarur ose leximi për kënaqësi u sjell fëmijëve përfitime në mënyra të shumta. Për shembull, masa që fëmijët lexojnë për kënaqësi dhe për obligime apo detyra shkollore është gjetur të jetë një kontribues kryesor në arritjen dhe aftësinë e tyre në të lexuar. Në anën tjetër, Cunningham dhe Stanovich (1998) gjetën se numri i pavarur i librave të lexuar është një parashikues i fuqishëm i dallimeve në fjalorin e fëmijëve dhe diferencat e përgjithshme të njohurive, edhe pas krahasimit të aftësive të përgjithshme përkatëse, siç janë IQ ose aftësitë e deshifrimit të tekstit. Më pas, Elley (1992) ka gjetur se për nxënësit në shkollë të mesme të ulët, në 32 vende, frekuenca e leximit kontribuon ndjeshëm në arritshmërinë dhe kuptueshmërinë në të lexuar.

Të gjetura të ngjashme dolën edhe nga studimi i OECD Reading for Change (2002), ku kënaqësia në të lexuarit ishte më e rëndësishme për suksesin akademik të fëmijëve sesa statusi socio-ekonomik i familjeve të tyre. Tutje, ekzistojnë dëshmi që sasia e të lexuarit jo vetëm që ndikon në arritshmërinë e leximit dhe suksesin e përgjithshëm akademik, por gjithashtu rrit njohuritë e përgjithshme (Cunningham & Stanovich, 1997), aftësitë shoqërore dhe pjesëmarrjen në komunitet (Guthrie, Schafer, & Hutchinson, 1991).

Aktiviteti i të lexuarit gjithashtu mund të ndihmojë fëmijët të kompensojnë nivelet më të ulëta të aftësisë njohëse duke ndërtuar fjalorin dhe njohuritë e tyre të përgjithshme (Cunningham & Stanovich, 1998). Në të kundërt, fëmijët që lexojnë shumë pak, nuk marrin përfitimet që vijnë nga leximi, dhe studimet tregojnë se kur lexuesit në vështirësi nuk janë të motivuar të lexojnë, mundësitë e tyre dhe motivimi i tyre për të mësuar, dhe suksezi akademik ulen ndjeshëm (Baker, Dreher, & Guthrie, 2000).

Sidoqoftë, gjithnjë e më shumë, ka pasur interes për rëndësinë e motivimit të fëmijëve dhe si mund të ndikojë në performancën e të kuptuarit të leximit dhe rritjen e aftësive të të kuptuarit të leximit (Baker & Wigfield, 1999; Gottfried, 1990; Taboada, Tonks, Wigfield, & Guthrie, 2009; Wang & Guthrie, 2004). Roli i motivimit në të kuptuarit e leximit të fëmijëve nuk mendohet se vepron veçmas nga aftësitë njohëse që mbështesin performancën e tyre; përkundrazi, mendohet se vepron si një energjizues (Taboada et al., 2009), i cili angazhon aftësi njohëse të fëmijëve dhe çon në nivele më të mëdha të suksesit akademik. Ryan dhe Deci (2000) kanë hulumtuar dallimet midis motivimit të brendshëm (motivimi i brendshëm brenda një individi, p.sh., kurioziteti) dhe motivimi i jashtëm (faktorë motivues të jashtëm, p.sh., notat). Fëmijët të cilët janë të motivuar nga brenda, kanë tendencë të tregojnë këmbëngulje më të madhe dhe të bëjnë më shumë përpjekje në detyrë përmes vullnetit të tyre. Nga ana tjetër, fëmijët që janë të motivuar nga jashtë mund të kryejnë detyra me pakënaqësi dhe mosinteresim, përmes përmbushjes të një qëllimi të jashtëm ose shpërblimi që marrin në fund. Për më shumë, Wang dhe Guthrie (2004) gjetën se ndërsa motivimi i brendshëm i leximit kishte një lidhje pozitive të drejtpërdrejtë me të kuptuarit e tekstit, motivimi i jashtëm ishte i lidhur negativisht me kuptimin e tekstit. Ndërsa, Lau dhe Chan (2003) kanë vërtetuar se lexuesit e mirë dhe të dobët dallojnë ndjeshëm në nivelin e tyre të motivimit të brendshëm të leximit, por jo të motivimit të jashtëm.

Përveç motivimit dhe përfitimeve nga të lexuarit në aftësitë njohëse dhe sukses akademik, leximi i librave gjithashtu ndërlidhet me shëndet më të mirë dhe kënaqësi të fortë me jetën. Sipas një studimi të kryer në Kanada nga Hill Strategies (2010), krahasuar me ata që nuk lexuan një libër, lexuesit e librave: patën më shumë gjasa të raportojnë se kanë shëndet shumë të mirë ose të shkëlqyeshëm fizik (54% kundrejt 44%); patën më shumë gjasa të raportojnë se kanë shëndet të mirë ose të shkëlqyeshëm mendor (63% kundrejt 56%); ka shumë më shumë gjasa të vullnetarizohen (42% kundrejt 26%); ka më pak të ngjarë të ndjehen të bllokuar në një rutinë ditore (33% kundrejt 39%); janë më të predispozuar të raportojnë kënaqësi më

të madhe nga jeta (61% kundrejt 57%), si dhe gjithashtu leximi i librave fiktiv parashikon empatinë ndër fëmijë dhe adoleshentë (Mar, Oatley & Peterson, 2009).

Lidhur me këtë, në një studim tjetër më të zgjeruar u vërtetua se angazhimi në përvojat simulative të librave fiktiv mund të lehtësojë të kuptuarit e të tjerëve që janë të ndryshëm nga vetja jonë dhe që mund të shtojnë kapacitetin tonë për të rritur empatinë dhe të kuptuarit e diversitetit shoqëror. Në leximin e librave të ndryshëm për kënaqësinë e tyre, adoleshentët fitojnë njohuri të rëndësishme për marrëdhëniet e pjekura ndërpersonale, vlerat personale, identitetet kulturore dhe sociale, preferencat estetike, dhe të kuptuarit e botës fizike dhe realitetit të përgjithshëm shoqëror (Howard, 2013).

Leximi dhe mirëqenia psikologjike

Nxënësit mësojnë më shumë ose performojnë më me efikasitet kur u jepen zgjedhje rreth mësimëve të tyre (Cordova & Lepper, 1996; Reynolds & Symons, 2001). Ngjashëm, shumë nxënës raportojnë më shumë kënaqësi në të lexuar kur u jepen zgjedhje rreth librave (Parker & Lepper, 1992; Schraw, Flowerday, & Reisetter, 1998; Sweet, Guthrie, & Ng, 1998). Mësuesit gjithashtu miratojnë përdorimin e zgjedhjes në klasë dhe besojnë se rrit motivimin, zellshmërinë dhe performancën në të mësuar (Flowerday & Schraw, 2000). Angazhimi në të lexuar është një komponentë e rëndësishme në zhvillimin arsimor dhe socio-emocional të një fëmije (Wigfield et al., 2008). Niveli dhe sasia e kohës që fëmija kalon i angazhuar në aktivitete të shkrim-leximit ndikon në motivimin e tij ose të saj për të lexuar dhe në këtë mënyrë të fitojë arritje në këtë fushë. Në lidhje me konstruktet e motivimit, një studim i Deci, Vallerand, Pelletier dhe Ryan (1991) ka gjetur se nxënësit angazhohen në një aktivitet të të lexuarit kryesisht sepse është interesante ose e kënaqshme (motivim i brendshëm), ose ata dëshirojnë rezultatin dhe mund të dëshirojnë të marrin një shpërblim, siç mund të jetë një notë e mirë (motivimi i jashtëm). Tutje, një studim i Massimi, Campigotto, Attarwala dhe Baecker (2013) karakterizoi leximin për kënaqësi apo

relaksim si përfshirje të përqendrimit dhe përfshirjes më emocionale me tekstin që lexohet. Ky studim ka vërejtur gjithashtu që një lexues mund të lexojë për kënaqësi, për një nevojë për të mësuar ose zbavitur, për të gjetur informacion specifik ose për të shfletuar, për të kaluar provime dhe për të kaluar kohën. Për më tepër nga ky studim kuptohet se adoleshentët e rinj nxjerrin përfitime të shumta nga të lexuarit për kënaqësi apo relaksim. Nga këndvështrimi arsimor, të lexuarit për kënaqësi dhe relaksim ndihmon në përmirësimin e shkathtësive të shkrim-leximit dhe të të menduarit, si dhe ndihmon ata/ato të sqarojnë dhe të eksplorojnë qëllimet e karrierës. Nga këndvështrimi social dhe emocional, leximi i kënaqësisë i ndihmon adoleshentët e rinj të kuptojnë ngjarjet historike dhe ato të tanishme, i ndihmon ata të zhvillojnë dhembshuri dhe empati, i fuqizon ata të zhvillohen dhe të veprojnë në bindjet e tyre dhe ndihmon për të kuptuar pasojat e sjelljeve të rrezikshme. Ndërsa, për nga këndvështrimi personal, të lexuarit për kënaqësi u ofron adoleshentëve të rinj argëtim, relaksim, dhe vepron si një mjet për të zhvilluar imagjinatën e tyre (Howard, 2011).


Në anën tjetër, studimet empirike kanë gjetur se vajzat kanë tendencë të kenë qëndrime më pozitive për të lexuarit sesa djemtë (Downing & Che, 1982). Studimet përgjatë viteve mbështesin qartë se gjinia është një variabël e fuqishme e lidhur me motivimin e shkrim-leximit (Kush & Watkins, 1996; Merisuo-Storm, 2006; Twist, Gnaldi, & Schagen, 2004). Dhe ndërsa dihet për disa vite që djemtë adoleshentë raportojnë ulje të motivimit për të lexuar (McKenna, Kear, & Ellsworth, 1995; Wigfield & Guthrie, 1997), hulumtimet e fundit zbulojnë se dallimet gjinore në lidhje me qëndrimin dhe motivimin janë të pranishme në lexuesit e rinj (Durik et al., 2006; Pecjak & Peklaj, 2006; Smith & Wilhelm, 2002). Ndër faktorët emocional që ndikojnë në sasinë dhe kualitetin e të lexuarit është qëndrimi i fëmijës ndaj leximit dhe librit. Zhvillimi i qëndrimeve pozitive ndaj të lexuarit është shoqëruar me lexim më të qëndrueshëm dhe më të vazhdueshëm edhe gjatë fazave të mëvonshme të jetës (Cullinan, 1987). Pra, ekziston marrëdhënie pozitive midis kënaqësisë, qëndrimit, sjelljes dhe arritshmërisë në të lexuar. Supozohet se në mënyrë implicite fëmijët në

moshë shkollore që gëzojnë përvojat e tyre të leximit dhe shkrimit zhvillojnë aftësi të avancuara të shkrim-leximit duke përfshirë edhe aktivitete tjera shtesë të lidhura me këtë aspekt të rëndësishëm arsimor (Clark & De Zoysa, 2011). Motivimi për të lexuar dhe të lexuarit si sjellje, zakonisht shihen si ndërmjetësues të mundshëm të efekteve të motivimit të leximit në arritshmërinë e të lexuarit (Schiefele, Schaffner, Moeller, & Wigfield, 2012). Me këtë kuptojmë që të lexuarit është një aktivitet që shpesh përfshin zgjedhjen e vetë fëmijës për librat apo materialet e tjera, duke theksuar dhe kuptuar që motivimi është thelbësor për angazhimin në të lexuar (Wigfield, Guthrie, Tonks, & Perencevich, 2004). Howard (2011) për më tepër thekson se leximi për arsye të relaksimit dhe kënaqësisë shërben disa funksione për adoleshentët e rinj që tejkalojnë argëtimin e thjeshtë. Për adoleshentët e rinj, leximi për arsye të kënaqësisë apo të relaksimit mund të kuptohet në kontekstin e kërkimit të informacionit në jetën e përditshme, model i cili thekson faktorët social dhe psikologjik që ndikojnë në zgjedhjet e kërkimit të informacionit në kontekstet e përditshme (Savolainen, 2005). Kështu, adoleshentët nuk kanë motiv parësor të kërkojnë informacion kur lexojnë për kënaqësi; përkundrazi, ata marrin informacione si përfitim dytësor i këtij aktiviteti. Për më tepër, ky studim ofron mbështetje për teorinë e përgjigjes së lexuesit, e cila thekson rolin aktiv të lexuesit në ndërtimin e kuptimit nga tekstet që lexohen (Ross, 2005). Në përputhje me teorinë e përgjigjes së lexuesit, tutje argumentohet që tekstet e shkruara për lexuesit adoleshentë nuk duhet të zvogëlohen, sepse funksioni i tyre kryesor është të ofrojnë argëtim. Pra, "leximi kritik aktiv mund të bëhet me çdo tekst si stimul" (f. 54) sepse lexuesit sjellin gamën e përvojave, interesave, ideve, ndjenjave dhe nevojave të tyre në aktin e leximit. Në këtë rrafsh, modeli zhvillimor i kësaj qasjeje për teorinë e përgjigjes së lexuesit është paraqitur nga Thomson (1987), ku përshkruan disa nivele të përgjigjes ndaj një teksti. Sipas Harding (1962) në Thomson (1987), në momentin që lexuesit kalojnë nivelin e të kuptuarit themelor të tekstit, ata marrin rolin e një analizuesi dhe gjatë kësaj kohe ndodhin tre procese kryesore, si rezultat i ndërveprimit të lexuesit me tekstin: 1. Bashkëndjenja - empatizimi (me përvojën e

personazheve të tjerë), 2. Vlerësimi i personazheve, 3. Pranimi ose refuzimi i vlerave të autorit të paraqitura në tekstin që lexohet.

Leximi dhe inteligjenca emocionale

Sipas Reuven Bar-On (2005), përkundër nivelit të rritur të interesit për inteligjencën emocionale gjatë dekadës së kaluar, studiuesit kanë hulumtuar këtë konstrukt për pjesën më të madhe të shekullit XIX. Ndërkohë, edukatorët dhe politikëbërësit janë bërë gjithnjë e më të vetëdijshëm për rëndësinë e ofrimit të mundësive arsimore për nxënësit në mënyrë që të përmirësojnë zhvillimin e tyre emocional (Graczyk, Weissberg, & Payton, 2000, si i cituar në Bryant, 2007). Në dy dekadat e fundit, një dimension i ri i inteligjencës, i quajtur inteligjencë emocionale (IE), ka marrë shumë vëmendje si përgjegjës për suksesin akademik të fëmijëve, më shumë sesa koeficienti i inteligjencës (IQ) (Goleman, 1995a). Goleman theksoi se vetëm rreth 20% e diferencës individuale në performancën e punës ose suksesin në karrierë mund t'i atribuohet IQ, dhe sugjeroi që varianca e mbetur 80% është e lidhur me inteligjencën emocionale. Inteligjenca emocionale po ashtu ka dëshmuar të jetë një parashikues më i mirë i suksesit sesa metodat tradicionale si GPA, IQ, dhe rezultatet e standardizuara të testeve të tjera (Davoudi, Nafchi, & Khodabakhshi, 2015). Në anën tjetër, dëshmohet se inteligjenca emocionale mund të ketë ndërlidhje të rëndësishme me një numër faktorësh të rëndësishëm të marrëdhënieve të shëndosha ndërnjerëzore, siç janë madhësia dhe cilësia e rrjeteve sociale (Ciarrochi et al., 2001), marrëdhënie pozitive me të tjerët (Lopes, Salovey, & Straus, 2003) dhe kënaqësia e jetës (Palmer, Donaldson, & Stough, 2002; Saklofske, Austin, & Minski, 2003). Inteligjenca emocionale është e përbërë nga tre nivele aftësish - perceptimi, kuptimi dhe menaxhimi - të gjitha janë aftësi zhvillimore dhe jetësore për përshtatje të suksesshme. Konsiderohet se



Inteligjenca emocionale i referohet aftësisë së individit për të identifikuar dhe menaxhuar emocionet e veta, si dhe për të identifikuar emocionet e të tjerëve.

këto përbërës ndikojnë thellësisht në përshtatje me marrëdhëniet shoqërore (Salovey & Sluyter, 1997). Pra, inteligjenca emocionale në përgjithësi i referohet më shumë aftësisë së individit për të identifikuar dhe menaxhuar emocionet e veta, si dhe identifikimin e emocioneve të të tjerëve. Në këtë kuptim, inteligjenca emocionale përfshin: vetëdijen emocionale ose aftësinë e individit për të identifikuar dhe emërtuar emocionet e veta; aftësinë për të shfrytëzuar ato emocione dhe për t'i zbatuar ato në detyra si të menduarit dhe zgjidhja e problemeve; dhe aftësinë për të menaxhuar emocionet, që përfshin rregullimin e emocioneve të veta kur është e nevojshme dhe të ndihmuarit e të tjerëve për të bërë të njëjtën gjë.

Fëmijët të cilët kanë pikë më të ulta në inteligjencën emocionale shpesh keqinterpretojnë emocionet e tyre dhe të të tjerëve. Këtyre fëmijëve u mungon aftësia për të menaxhuar emocionet e tyre siç duhet dhe shpesh mund të shfaqin sjellje agresive në klasë. Një sjellje e tillë shpesh çon në refuzim të bashkëmoshatarëve, gjë që mund të shkaktojë një rritje të stresit emocional (Gibbs, 1995). Ky tjetërsim mund të pengojë më tej përvetësimin e aftësive shoqërore jetësore, suksesin akademik dhe suksesin e përgjithshëm edhe në aspekte të tjera jetësore. Studimet vënë në pah nevojën që kontekstet e edukimit të sigurojnë kurse lidhur me inteligjencën emocionale, për të rritur aftësitë/kapacitetet e nxënësve për të menaxhuar në mënyrë të duhur emocionet (p.sh. kurse lidhur me menaxhimin e emocioneve, komunikimin ndërpersonal dhe vetëkonceptin), si dhe t'u ndihmojnë studentëve të zhvillojnë aftësitë për të nxënë përmes simulimit të luajtjes së roleve (Roberts, 2009). Leximi dhe analizimi i librave njohur ndryshe si biblioterapia është intervenim me karakter psikologjik në kontekstin e klasës dhe grupit, dhe është konsideruar të jetë i zbatueshëm për promovimin dhe përforcimin e inteligjencës emocionale. Këto teknika forcojnë njohuritë, kuptimin, vlerësimin dhe krahasimin e ngjarjeve dhe teksteve duke integruar leximin e librave me intervenimin në aspektin socio-emocional të fëmijëve.

Gjithashtu, ka disa shpjegime për ndërlidhjen midis leximit të librave fiktiv dhe empatisë (Mar et al., 2006). Gjatë kohës që lexohen libra fiktiv, simulimi i përvojës sociale që ndodhë mund të përfshijë të njëjtat procese-njohëse të përdorura gjatë të

kuptuarit shoqëror të botës reale (d.m.th., konkluzion mendor, gjurmimi i qëllimeve, njohje të emocioneve dhe sjelljeve sociale). Ndërhyrja duke theksuar kompetencën sociale përgatit nxënësit për sfidat ndërnjerëzore dhe profesionale me të cilat do të përballen. Biblioterapia në klasë, apo edhe vetë leximi i librave mund të promovojë këto aftësi thelbësore dhe kështu të ndihmojë fëmijët të fitojnë kompetencën socio-emocionale për të cilën do të duhet të bëhen të suksesshëm në shkollë dhe më gjerë.

Leximi në Kosovë

Në kontekstin kosovar mungojnë të dhëna empirike rreth rolit apo efektit të leximit në mirëqenien dhe inteligjencën emocionale të fëmijëve, mirëpo ekzistojnë studime empirike të cilat tregojnë për trendin e lexueshmërisë në mesin e fëmijëve. Fëmijët kosovarë nuk janë lexues të librave në përgjithësi, dhe kjo u tregua nga raportet hulumtuese që gjetën se leximi në Kosovë ka rënë ndjeshëm. Fillimisht, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (2018) në publikimin “Statistikat e Kulturës” për vitin 2018, mësohet se numri i lexuesve në Kosovë gjatë vitit 2018 në bibliotekat publike ishte 156,535. Nëse krahasohet me statistikën e vitit 2017 shohim se numri i lexuesve në biblioteka ka rënë për 1,641 sosh. Rënia më e madhe ishte në vitin 2017, kur sipas statistikave, Kosova numëroi 120,000 lexues më pak se në vitin paraprak. Tutje, rezultate të tilla për lexueshmërinë tregojnë edhe raporti i hulumtimit në vitin 2019, i realizuar nga organizata ETEA, ku u gjetë se deri në 73% e të anketuarve nuk kujtojnë tre titujt të librave. Ndërsa, deri në 46% e nxënësve nuk kujtojnë herën e fundit që kanë parë prindërit e tyre duke shfletuar një libër. Për më tej, sipas raportit të ETEA-s, del se ekspozimi ndaj librit dhe aktiviteteve që promovojnë librin kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nxitjen e lexueshmërisë. Po ashtu, nga ky hulumtim ka dalur se familja, shoqëria, mësimdhënësit dhe infrastruktura si faktorë relevantë janë të rëndësishëm në formësimin e shprehësive të leximit ndër fëmijë. Ndërsa, leximi i librave me vetëdëshirë është edhe më i ulët ndër nxënës të anketuar. Vetëm 26.7% kanë qenë në gjendje të listojnë tre librat e fundit të lexuar me vetë dëshirë. Ndërkohë që, 16.9% kanë arritur t’i kujtojnë dy tituj, ndërsa 22.6% nuk kanë kujtuar vetëm një libër jashtëkurrikular të lexuar (Alidemaj & Sijarina, 2019). Marrë parasysh rëndësinë e

leximit në shumë aspekte të jetës së fëmijëve, sipas studimeve të lartëcekura përgjatë shqyrtimit të literaturës, përkatësisht në suksesin akademik dhe shëndetin mendor, konsiderohet e rëndësishme një pasqyrë e kësaj ndërlidhjeje potenciale në kontekstin kosovar. Andaj, duke marrë parasysh rëndësinë që ka të lexuarit në zhvillimin kognitiv, emocional e social tek fëmijët, është jetike që ky rol të mos mbetet i paevidentuar.

Qëllimi i hulumtimit

Fillimisht, në Kosovë nuk ka mjaftueshëm hulumtime të cilat studiojnë faktorë të rëndësishëm për të kuptuar më thellë ndërlidhjen mes leximit, mirëqenies psikologjike dhe inteligjencës emocionale tek fëmijët. Numërojmë disa hulumtime të nxjerra për nivelin e lexueshmërisë në shkollat fillore dhe deri të mesme të larta, mirëpo deri më tani, ky studim mbetet i pari i këtij lloji dhe kësaj tematike. Qëllimi kryesor i tij është të kuptojë më tutje ndërlidhjen mes të lexuarit dhe shëndetit mendor, përkatësisht mirëqenies psikologjike dhe inteligjencës emocionale. Marrë për bazë këtë, për të konkretizuar më tej qëllimin kryesor, objektivat kryesore të këtij studimi janë:

1. Të kuptojë se cilat lloje të motivimit për të lexuar shoqërohen me MP dhe IE më të lartë tek nxënësit e Kosovës
2. Të kuptojë se cilat zhanre të librave shoqërohen me MP dhe IE më të lartë tek nxënësit e Kosovës
3. Të kuptojë a ekzistojnë dallime gjinore në MP dhe IE tek nxënësit e Kosovës
4. Të kuptojë se çfarë efekti ka regjistrimi në bibliotekë shkollore apo të qytetit në MP dhe IE të nxënësve të Kosovës
5. Të kuptojë se si mund të parashikohet MP dhe IE e nxënësve të Kosovës në bazë të nivelit të tyre të lexueshmërisë
6. Të kuptojë se çfarë efekti ka pëlqyeshmëria e të lexuarit në MP dhe IE të nxënësve të Kosovës
7. Të kuptojë se çfarë efekti ka të lexuarit aktiv në MP dhe IE të nxënësve të Kosovës
8. Të kuptojë se çfarë efekti biseda e fëmijëve me prindërit e tyre lidhur me libra ka në MP dhe IE të fëmijëve të Kosovës
9. Të kuptojë opinionet dhe përvojat e psikologëve shkollorë rreth të lexuarit, MP dhe IE të fëmijëve të Kosovës

Metodologjia



Metodologjia

Lloji i studimit

Ky hulumtim është realizuar duke përdorur një metodologji të përzier, e cila përfshiu të dhëna sasiore dhe cilësore. Përpos hulumtimit dytësor të shqyrtimit të literaturës, anketimi u përdor për të mbledhur të dhënat numerike ndërsa të dhënat tekstuale u mblodhën përmes intervistave. Të dhënat sasiore, të mëdha në numër por të limituara nga përmbajtja u plotësuan me të dhënat cilësore të cilat na ofruan një perspektivë më të thelluar mbi çështjen e studiuar. Prandaj, ndërveprimi i të dhënave sasiore dhe cilësore ishte i nevojshëm për të arritur qëllimin e hulumtimit.

Mostra

Në pjesën sasiore të këtij studimi morën pjesë 983 pjesëmarrës (62.8% vajza, 37.2% djem), të rangut të moshave 10-15, me një moshë mesatare 13.17 ($DS = 1.17$). Pjesëmarrësit ishin nxënës të shkollave të mesme të ulëta të Kosovës, ku 19.7% e tyre ishin në klasën e 6, 23.8% në klasën e 7, 37.6% në klasën e 8 dhe 18.7 në klasën e 9. Nxënësit vinin nga 20 komuna dhe 68 shkolla të ndryshme, të paraqitura më poshtë me grafe. Nga ta, 59.7% jetonin në vende urbane, 27.6% në vende rurale, ndërsa 12.7 nuk deklaruan. Më tutje, 87.7% ishin shqip-folës ndërsa 12.3% folës të gjuhës serbe. Në fund, në pjesën cilësore të hulumtimit morën pjesë 6 psikologë shkollorë (4 gra, 2 burra), të cilët ishin (në rend alfabetik): Doruntina Asllani, Ergita Zajmi, Nikola Mitic, Saranda Rexha, Trëndelina Krasniqi dhe Valdet Plakolli. Nga ta, 5 ishin shqiptar ndërsa 1 serb.

Të dhënat e këtij hulumtimi janë mbledhur elektronikisht gjatë periudhës Mars – Korrik të vitit 2020.

Gjinia e pjesëmarrësve




Fig.1. Shpërndarja gjinore e pjesëmarrësve

Mosha e pjesëmarrësve




Fig.2. Mosha e pjesëmarrësve

Klasa e pjesëmarrësve




Fig.3. Klasa në të cilën pjesëmarrësit bëjnë pjesë

Vendbanimi i pjesëmarrësve




Fig.4. Vendbanimi i pjesëmarrësve





Fig.5. Komuna e pjesëmarrësve

Shkolla e pjesëmarrësve



Procedura

Të dhënat e hulumtimit u mblodhën në mënyrë elektronike përmes anketave dhe intervistave. Të dhënat sasiore u mblodhën përmes anketave në webfaqen Google Forms. Metoda e mostrimit ishte teknika e topit të borës, ku nxënësit u ftuan të ndajnë vegzën e pyetësorit me shokët dhe shoqët e tyre. Përpos fëmijëve, edhe bashkëpunimi me mësimdhënës ishte i nevojshëm që të sigurohen pjesëmarrësit.

Fillimisht, u realizua një pilot testim me 30 nxënës shqiptar dhe 5 nxënës që ishin serb. Faza e pilotimit ka shërbyer për: 1) të gjetur vlerat psikometrike të instrumenteve; 2) Të vërtetuar nëse pyetësorët e caktuar janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe në mënyrë të denjë; dhe 3) të marrur komente dhe sygjjerime nga pjesëmarrësit. Vlerat psikometrike të pyetësorit ishin të gjitha të përshtatshme; nga komentet e nxënësve kuptuam që pyetësori ishte i kuptueshëm në gjuhën shqipe dhe serbe; si dhe janë adresuar disa sygjjerime të fëmijëve.

Pjesëmarrësve u është bërë e ditur që në fillim qëllimi i hulumtimit. Secili pjesëmarrës ka qenë i informuar paraprakisht për mënyrën e plotësimit, konfidencialitetin dhe të gjitha informatat e nevojshme për ta kuptuar dhe për ta plotësuar në mënyrën e saktë pyetësorin. Koha e nevojshme për plotësimin e pyetësorit ka qenë rreth 20 minuta. Duke respektuar parimet etike dhe profesionale, pjesëmarrësit kanë patur mundësinë të anulojnë plotësimin e pyetësorit në rast se ata nuk ndihen mirë gjatë plotësimit dhe kjo informatë u është dhënë në fillim të pyetësorit.

Instrumentet

Për të matur variablat e studimit, krahas informatave demografike, janë përdorur katër pyetësorë të bashkuar në një. Të dhënat demografike të kërkuara nga pjesëmarrësit ishin informata lidhur me gjininë e tyre, moshën, klasën, komunën, shkollën, dhe vendbanimin (urban/rural).

Pyetësori për lexueshmërinë: është përdorur një verzion i modifikuar i pyetësorit të

lexueshmërisë, i dizajnuar dhe përdorur nga ETEA në hulumtimet e mëparshme lidhur me këtë fenomen. Në këtë pyetësor kishte pyetje lidhur me sa shpesh lexojnë fëmijët brenda një viti; cilat janë zhanret e preferuara të librave; a mund t'i emërtojnë tre libra të fundit që kanë lexuar; a kanë kënd të librave në shtëpi, a janë të regjistruar në bibliotekën e shkollës dhe të qytetit, etj.

Pyetësi për leximin aktiv: është një pyetësor i cili është përpiluar nga ekipi hulumtues për të matur shkallën se sa lexojnë fëmijët në mënyrë aktive. Pyetësi përmban 6 deklaratë lidhur me shprehje gjatë leximit (deklaratë shembull: *“Gjatë leximit, marr shënime në fletore/kompjuter”*), të cilat mund të vlerësohen me një shkallë nga 1 (asnjëherë) deri në 5 (gjithmonë). Konsistenca e brendshme e pyetësit ka rezultuar e mirë, e treguar nga α e Cronbach = .806.

Shkalla Stirling e Mirëqenies së Fëmijëve: është një instrument i cili përmban 12 pyetje (nga të cilat janë përdorur 11) që masin dy dimensione të mirëqenies: Gjendjen Pozitive Emocionale – 6 deklaratë (*“Gjatë javëve të fundit, jam ndjerë i/e relaksuar”*): dhe Këndvështrimin Pozitiv – 5 deklaratë (*“Mendoj se ka shumë njerëz të cilëve ua ndien për mua”*). Deklaratat janë vlerësuar me një shkallë nga 1 (kurrë) deri në 5 (tërë kohën). Dimensioi “Gjendja Pozitive Emocionale” rezultoi me konsistencë të brendshme të dobët ($\alpha = .588$), ndërsa dimensioi “Këndvështrimi Pozitiv” me konsistencë të brendshme të mirë ($\alpha = .749$).

Inteligjenca Emocionale e Nxënësve (Raghavan & Panboli, 2018): është një instrument i cili përmban 27 pyetje (nga të cilat janë përdorur 21) që masin pesë dimensione të inteligjencës emocionale: Vetë-vetëdijen – 4 deklaratë (*“Unë mund të kuptoj fuqitë dhe dobësitë e mia”*); Aftësitë vetë-rregulluese – 4 deklaratë (*“Mundohem të largoj frikën e panevojshme ndaj gjërave”*); Motivimin – 4 deklaratë (*“Unë motivoj veten duke imagjinuar një rezultat të mirë për punën që jam duke bërë”*); Empatinë – 4 deklaratë (*“Unë mund të vërej se si të tjerët po ndihen nga toni i zërit të tyre”*) dhe Aftësitë sociale – 5 deklaratë (*“Unë ndihmoj të tjerët për t'u ndjerë më mirë kur ata po ndihen keq”*). Deklaratat janë vlerësuar me një shkallë nga 1 (nuk pajtohem aspak) deri në 5

(pajtohem plotësisht). Dimensioni “Vetë-vetëdija” ka rezultuar me konsistencë të brendshme të pranueshme ($\alpha = .640$); “Aftësitë vetë-rregulluese” me konsistencë të brendshme po ashtu të pranueshme ($\alpha = .643$); “Motivimi” me konsistencë të brendshme të mirë ($\alpha = .801$); “Empatia” me konsistencë të brendshme të mirë ($\alpha = .727$); dhe “Aftësitë sociale” me konsistencë të brendshme po ashtu të mirë ($\alpha = .798$).

Strategjia Analizuese

Të dhënat sasiore janë analizuar me programin statistikor SPSS (Statistical Package for Social Sciences), dhe janë performuar analiza si *t*-testi (për të gjetur dallime në mes të dy grupeve), ANOVA (për të gjetur dallime në mes të tre apo më shumë grupeve) si dhe Regresioni linear (për të parë efektin e një variable në një variablën tjetër). Ndërsa, analiza e të dhënave cilësore është bërë manualisht nga ekipi hulumtues.

Rezultatet



Rezultatet

Rezultatet sasiore

Llojet e motivimit, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale

Fillimisht, janë analizuar faktorët që motivojnë nxënësit të lexojnë dhe si ata faktorë shoqërohen me mirëqenien psikologjike (MP) dhe inteligjencën emocionale (IE). Në mes të 5 llojeve të motivimit, “shijimi i leximit” është shoqëruar me mesatare më të lartë të MP ($M = 41.54$), ndërsa fëmijët që kanë deklaruar se “asgjë” nuk i motivon të lexojnë kanë shënuar pikët dukshëm më të ulëta në MP ($M = 38.19$).




Fig.7. Faktorët motivues që shtyjnë fëmijët të lexojnë dhe mesatarja e mirëqenies së tyre psikologjike

Ndërsa, dy llojet e motivimit që janë shoqëruar me pikët më të larta të IE janë “relaksimi gjatë leximit” ($M = 84.55$) dhe “nevoja për të marrë informacion” ($M =$

84.54). Ngjashëm me konstruktin paraprak, nxënësit që kanë zgjedhur se “asgjë” nuk i motivon të lexojnë kanë shënuar pikët dukshëm më të ulëta në IE ($M = 79.19$).




Fig.8. Faktorët motivues që shtyjnë fëmijët të lexojnë dhe mesatarja e inteligjencës së tyre emocionale

Zhanret e librave, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale

Pjesëmarrësit janë pyetur lidhur me zhanret e tyre të preferuara të librave dhe pastaj është analizuar se me çfarë mesataresh të MP dhe IE shoqërohen ato zhanre. Dy zhanret që janë shoqëruar me më së shumti pikë mesatare të MP janë “Biografi & Autobiografi” ($M = 40.61$) dhe “Poezi” ($M = 39.76$), ndërsa, fëmijët që kanë zgjedhur se nuk lexojnë asnjë zhanër kanë shënuar pikët më të ulëta në MP ($M = 34.08$).




Fig.9. Zhanret e preferuara të librave dhe mesatarja e mirëqenies psikologjike të fëmijëve

Ndërsa, dy zhanret e librave që janë shoqëruar me IE më të lartë të fëmijëve janë librat “Uestern (perëndimor)” ($M = 85.55$) dhe “Librat shkollorë” ($M = 85.50$). Ngjashëm, pjesëmarrësit që kanë zgjedhur se “nuk lexojnë” asnjë zhanër të librave kanë shënuar pikët më të ulëta në matjen e IE ($M = 74.6$).




Fig.10. Zhanret e preferuara të librave dhe mesatarja e inteligjencës emocionale të fëmijëve

Dallimet gjinore në mirëqenien psikologjike & inteligjencën emocionale

Pjesë e qëllimeve të këtij hulumtimi ka qenë edhe analizimi se a ekzistojnë dallime gjinore në MP dhe IE në mes të nxënësve vajza dhe djem të Kosovës. Janë performuar dy analiza të *t*-test, të cilat kanë treguar se nuk ekzistojnë dallime signifikante gjinore në asnjërën nga dy konstruktet e përmendura. Edhe pse vajzat kanë shënuar mesatare më të mëdha edhe në MP ($M = 39.52$, $DS = 6.52$) edhe në IE ($M = 83.91$, $DS = 12.2$) sesa djemtë (MP: $M = 39.34$, $DS = 6.85$; IE: $M = 82.64$, $DS = 13.45$), dallimet nuk janë signifikante, siç tregohet nga $t(981) = -.392$, $p = .695$ (për MP) si dhe $t(981) = -1.506$, $p = .132$ (për IE).

	Vajzë (N=617)		Djalë (N=366)		t	Sig(p)
	M	DS	M	DS		
Mirëqenia Psikologjike	39.52	6.52	39.34	6.85	-.392	.695
Inteligjenca Emocionale	83.91	12.2	82.64	13.45	-1.506	.132

Tabela.1. Analiza e *t*-test për të gjetur a ka dallime gjinore në MP dhe IE tek nxënësit e Kosovës

Regjistrimi në bibliotekë, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale

Për të parë se a ka dallime signifikante në MP dhe IE në mes të fëmijëve që janë të regjistruar në biblioteka dhe atyre që nuk janë, janë performuar disa analiza të *t*-test.

Fillimisht, është analizuar regjistrimi në bibliotekën e shkollës. Fëmijët që janë të regjistruar në bibliotekën e shkollës) kanë raportuar inteligjencë emocionale më të lartë ($M = 84.43$, $SD = 12.39$) sesa ata që nuk janë të regjistruar në të ($M = 81.61$, $SD =$

13.20). Kjo tregohet nga $t(981) = 3.328$, $p = .001$. Ndërsa, nuk kishte dallime signifkante në MP.

	Të regjistruar në bibliotekën e shkollës (N=637)		Të paregjistruar në bibliotekën e shkollës (N=346)		t	Sig(p)
	M	DS	M	DS		
Mirëqenia Psikologjike	39.63	6.63	39.13	6.68	1.139	.255
Inteligjenca Emocionale	84.43	12.39	81.61	13.20	3.328	.001

Tabela.2. Analiza e t-test për të gjetur se a ka dallime në MP dhe IE në mes të fëmijëve që janë të regjistruar në bibliotekën e shkollës dhe atyre që nuk janë

Pastaj, është analizuar regjistrimi në bibliotekën e qytetit. Fëmijët që janë të regjistruar në bibliotekën e qytetit ($M = 40.76$, $SD = 5.93$) kanë raportuar mirëqenie psikologjike më të lartë sesa ata që nuk janë të regjistruar në të ($M = 39.02$, $SD = 6.82$). Kjo tregohet nga $t(981) = 3.590$, $p = .000$. Po ashtu, fëmijët që janë të regjistruar në bibliotekën e qytetit ($M = 84.80$, $SD = 11.74$) kanë raportuar edhe inteligjencë emocionale më të lartë sesa ata që nuk janë të regjistruar ($M = 82.98$, $SD = 13.04$), siç tregohet nga rezultatet pothuajse signifkante $t(981) = 1.943$, $p = 0.52$.

	Të regjistruar në bibliotekën e qytetit (N=246)		Të paregjistruar në bibliotekën e qytetit (N=737)		t	Sig(p)
	M	SD	M	SD		
Mirëqenia Psikologjike	40.76	5.93	39.02	6.82	3.590	.000
Inteligjenca Emocionale	84.80	11.74	82.98	13.04	1.943	.052

Tabela.3. Analiza e t-test për të gjetur se a ka dallime në MP dhe IE në mes të fëmijëve që janë të regjistruar në bibliotekën e qytetit dhe atyre që nuk janë

Leximi i librave jashtë-kurrikular, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale

Në vazhdim, është performuar një analizë e variancës (ANOVA) për të analizuar nëse ka dallime në mirëqenie psikologjike dhe inteligjencë emocionale në mes të fëmijëve që mund të numërojnë tre libra jashtë-kurrikular që kanë lexuar së fundmi, dy libra, një libër, dhe atyre që nuk mund të listojnë asnjë.

MP: Nxënësit që kanë mundur të numërojnë tre libra jashtë-kurrikular që kanë lexuar së fundmi ($M = 41.49$, $SD = 5.95$), ata të cilët kanë mund të numërojnë dy ($M = 40.87$, $SD = 5.60$) dhe ata të cilët kanë mundur të numërojnë të paktën një ($M = 39.49$, $SD = 5.59$) raportuan mirëqenie psikologjike më të lartë sesa ata të cilët nuk listuan as një libër ($M = 38.21$, $SD = 6.06$). Dallimet grupore janë signifikante, siç tregohet nga $F(3, 856) = 10.956$, $p = .000$, $\eta^2 = 0.037$. Pastaj, është performuar analiza e Tukey për të analizuar se cilat nga grupet e studiuara kanë dallime signifikante ndërmjet njëra-tjetrës, dhe rezultatet janë paraqitur të graf.




Fig.11. Mirëqenia psikologjike e fëmijëve që kanë listuar 0, 1, 2 apo 3 libra jashtë-kurrikular që i kanë lexuar së fundmi

IE: Nxënësit që kanë mundur të numërojnë tre libra jashtë-kurrikular që kanë lexuar së fundmi ($M = 85.08$, $DS = 11.05$), ata të cilët kanë mund të numërojnë dy ($M = 84.34$, $DS = 10.87$) dhe ata të cilët kanë mundur të numërojnë të paktën një ($M = 80.66$, $DS = 12.79$)

raportuan inteligjencë emocionale më të lartë sesa ata të cilët nuk listuan as një libër ($M = 77.30$, $DS = 17.34$). Dallimet grupore janë signifikante, siç tregohet nga $F(3, 856) = 14.129$, $p = .000$, $\eta^2 = 0.047$. Pastaj, është performuar analiza e Tukey për të analizuar se cilat nga grupet e studiuara kanë dallime signifikante ndërmjet njëra-tjetrës, dhe rezultatet janë paraqitur të graf.




Fig 12. Inteligjenca emocionale e fëmijëve që kanë listuar 0, 1, 2 apo 3 libra jashtë-kurrikular që i kanë lexuar së fundmi

Hera e fundit e leximit, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale

Më tutje, është performuar një analizë e variancës (ANOVA) për të hetuar nëse ka dallime në mirëqenie psikologjike dhe inteligjencë emocionale në mes të fëmijëve që kanë lexuar një libër në muajin e fundit, atyre që kanë lexuar një libër në gjashtë muajt e fundit, atyre që kanë lexuar një libër në 12 muajt e fundit dhe atyre të cilëve nuk iu kujtohet hera e fundit që kanë lexuar një libër.

MP: Nxënësit që kanë lexuar një libër në muajin e fundit ($M = 40.72$, $DS = 6.30$), ata të cilët kanë lexuar një libër në gjashtë muajt e fundit ($M = 38.33$, $DS = 6.74$) dhe ata që kanë lexuar një libër në 12 muajt e fundit ($M = 37.67$, $DS = 6.62$) shënuan më shumë

pikë në matjen e mirëqenies psikologjike sesa ata të cilët nuk mund ta kujtojnë herën e fundit që kanë lexuar ndonjë libër ($M = 37.36$, $DS = 6.82$). Dallimet grupore janë të rëndësishme, siç tregohet nga $F(3, 979) = 15.354$, $p = .000$, $\eta^2 = 0.045$. Pastaj, është performuar analiza e Tukey për të hetuar se cilat nga grupet e studiara kanë dallime të rëndësishme ndërmjet njëra-tjetrës, dhe ka rezultuar se grupi “brenda muajit” ka dallime të rëndësishme me të tri grupet tjera, ndërsa të tri grupet tjera nuk kishin dallime të rëndësishme në MP në mes vete. Kjo do të thotë se fëmijët që kanë lexuar një libër brenda muajit të fundit kanë raportuar MP më të lartë, sesa tri grupet tjera, dhe gjetjet janë statistikisht të rëndësishme.




Fig 13. Mirëqenia psikologjike e fëmijëve që kanë lexuar ndonjë libër në muajin e fundit, në gjashtë muajt e fundit, në 12 muajt e fundit, dhe atyre që nuk iu kujtohet hera e fundit

IE: Nxënësit që kanë lexuar një libër në muajin e fundit ($M = 85.91$, $DS = 11.53$), ata të cilët kanë lexuar një libër në gjashtë muajt e fundit ($M = 81.83$, $DS = 11.85$) dhe ata që kanë lexuar një libër në 12 muajt e fundit ($M = 80.56$, $DS = 12.83$) shënuan më shumë pikë në matjen e inteligjencës emocionale sesa ata të cilët nuk mund ta kujtojnë herën e fundit që kanë lexuar ndonjë libër ($M = 77.97$, $DS = 16.21$). Dallimet grupore janë të rëndësishme, siç tregohet nga $F(3, 979) = 18.121$, $p = .000$, $\eta^2 = 0.053$. Në fund, është performuar analiza e Tukey për të hetuar se cilat nga grupet e studiuara kanë dallime të rëndësishme ndërmjet njëra-tjetrës, dhe ka rezultuar se grupi “brenda muajit” ka dallime të rëndësishme me të tri grupet tjera, ndërsa të tri grupet tjera nuk kishin dallime të rëndësishme në IE në mes vete. Kjo do të thotë se fëmijët që kanë lexuar një libër brenda muajit të fundit kanë raportuar IE më të lartë, sesa tri grupet tjera, dhe gjetjet janë statistikisht të rëndësishme.




Fig 14. Inteligjenca emocionale e fëmijëve që kanë lexuar ndonjë libër në muajin e fundit, në gjashtë muajt e fundit, në 12 muajt e fundit, dhe atyre që nuk iu kujtohet hera e fundit

Numri i librave të lexuara në vit, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale

Po ashtu, është performuar një tjetër analizë e variancës (ANOVA) për të gjetur nëse ka dallime në mirëqenie psikologjike dhe inteligjencë emocionale në varësi të numrit të librave që fëmijët lexojnë në një vit.

MP: Nxënësit që lexojnë 16 apo më shumë libra në vit ($M = 41.36$, $DS = 6.29$), ata që lexojnë 10 deri në 15 libra ($M = 41.43$, $DS = 5.58$), ata që lexojnë 5 deri në 9 libra ($M = 41.38$, $DS = 5.92$) dhe ata të cilët lexojnë 1 deri në 4 libra ($M = 39.61$, $DS = 5.93$) raportuan më shumë pikë në matjen e mirëqenies psikologjike sesa ata që deklaruan se nuk lexojnë libra kurrë ($M = 35.93$, $DS = 6.16$). Dallimet grupore janë signifikante, siç tregohet nga $F(4, 857) = 6.830$, $p = .000$, $\eta^2 = 0.031$. Pastaj, është performuar analiza e Tukey për të hetuar se cilat nga grupet e studiuara kanë dallime signifikante ndërmjet njëra-tjetrës, dhe dallimet janë paraqitur në grafën e mëposhtëm.




Fig 15. Mirëqenia psikologjike e fëmijëve në varësi të numrit të librave që lexojnë në vit

IE: Nxënësit që lexojnë 16 apo më shumë libra në vit ($M = 85.99$, $DS = 12.32$), ata që lexojnë 10 deri në 15 libra ($M = 85.81$, $DS = 10.32$), ata që lexojnë 5 deri në 9 libra ($M = 83.51$, $DS = 12.23$) dhe ata të cilët lexojnë 1 deri në 4 libra ($M = 80.97$, $DS = 13.12$) raportuan më shumë pikë në matjen e inteligjencës emocionale sesa ata që deklaruan se nuk lexojnë libra kurrë ($M = 70.68$, $DS = 20.51$). Dallimet grupore janë të rëndësishme, siç tregohet nga $F(4, 857) = 10.245$, $p = .000$, $\eta^2 = 0.046$. Pastaj, është performuar analiza e Tukey për të hetuar se cilat nga grupet e studiuara kanë dallime të rëndësishme ndërmjet njëra-tjetrës, dhe dallimet janë paraqitur në grafikonin e mëposhtëm.




Fig 16. Inteligjenca emocionale e fëmijëve në varësi të numrit të librave që lexojnë në vit

Pëlqyeshmëria e leximit, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale

Për të analizuar se si pëlqyeshmëria e leximit parashikon mirëqenien psikologjike të fëmijëve është performuar analiza e regresionit linear. Rezultatet tregojnë se modeli shpjegon 15.5% të ndryshueshmërisë së mirëqenies psikologjike, dhe se modeli është

signifikant, $F(1, 981) = 179.71, p = .000$. Atëherë, pëlqyeshmëria e leximit nga ana e fëmijëve ka efekt në mirëqenien e tyre psikologjike.




Fig 17. Trendi i ngritjes së mirëqenies psikologjike me ngritjen e pëlqyeshmërisë së të lexuarit

Ngjashëm, është performuar një analizë tjetër e regresionit linear për të analizuar se si parashikon pëlqyeshmëria e leximit inteligjencën emocionale të fëmijëve. Rezultatet tregojnë se modeli në mënyrë signifikante shpjegon 6.7% të ndryshueshmërisë së inteligjencës emocionale, $F(1, 981) = 70.60, p = .000$. Atëherë, pëlqyeshmëria e leximit nga ana e fëmijëve ka efekt edhe në inteligjencën e tyre emocionale.




Fig 18. Trendi i ngritjes së inteligjencës emocionale me ngritjen e pëlqyeshmërisë së të lexuarit

Të lexuarit aktiv, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale

Për të analizuar efektin e të lexuarit aktiv në mirëqenien psikologjike të fëmijëve është performuar analiza e regresionit linear. Rezultatet tregojnë se modeli shpjegon 16.4% të ndryshueshmërisë së mirëqenies psikologjike, dhe se modeli është signifikant, $F(1, 981) = 192.93, p = .000$. Pra, mund të themi se të lexuarit aktiv parashikon në mënyrë signifikante mirëqenien psikologjike të fëmijëve.




Fig 19. Trendi i ngritjes së mirëqenies psikologjike me ngritjen e të lexuarit aktiv

Ngjashëm, është performuar një analizë tjetër e regresionit linear për të analizuar se çfarë efekti ka të lexuarit aktiv në inteligjencën emocionale të fëmijëve. Rezultatet tregojnë se modeli në mënyrë signifikante shpjegon 12.6% të ndryshueshmërisë së inteligjencës emocionale, $F(1, 981) = 141.92, p = .000$. Pra, mund të themi se të lexuarit aktiv parashikon në mënyrë signifikante edhe inteligjencën emocionale të fëmijëve.




Fig 20. Trendi i ngritjes së inteligjencës emocionale me ngritjen e të lexuarit aktiv

Biseda me familjarët për libra, mirëqenia psikologjike dhe inteligjenca emocionale

Për të analizuar efektin që shpeshësia e bisedave për libra me familjarë ka në mirëqenien psikologjike të fëmijëve është performuar analiza e regresionit linear. Rezultatet tregojnë se modeli shpjegon 13.1% të ndryshueshmërisë së mirëqenies psikologjike, dhe se modeli është signifikant, $F(1, 981) = 147.900$, $p = .000$. Pra, mund të themi se bisedat e fëmijëve me familjarët e tyre lidhur me librat, kanë efekt signifikant në mirëqenien e tyre psikologjike.

Ngjashëm, është performuar një analizë tjetër e regresionit linear për të analizuar se çfarë efekti ka shpeshësia e bisedave për libra me familjarë në inteligjencën emocionale të fëmijëve. Rezultatet tregojnë se modeli në mënyrë signifikante shpjegon 9.4% të ndryshueshmërisë së inteligjencës emocionale, $F(1, 981) = 101.620$, $p = .000$. Kështu, mund të konkludojmë se të biseda e fëmijëve me familjarë për libra ka efekt signifikant edhe në inteligjencën emocionale të fëmijëve.




Fig 21. Trendi i ngritjes së mirëqenies psikologjike me ngritjen e të bisedës me familjarët për libra




Fig 22. Trendi i ngritjes së inteligjencës emocionale me ngritjen e të bisedës me familjarët për libra




Fig.23. Graf përmbledhës i të gjitha analizave konkluduese të performuara në këtë studim. Shënim: vijat e ndërprera nënkuptojnë rezultate jo-signifikante.

Rezultatet cilësore

Kategoria 1: Lexueshmëria si fenomen

Shumica e pjesëmarrësve u pajtuan që lexueshmëria në shkollat e mesme të ulëta të Kosovës është e mirë, edhe pse mund të jetë ende më e lartë. Disa nga pjesëmarrësit vlerësuan se një faktor kyç që do të shtynte fëmijët të lexojnë më shumë, do të ishte furnizimi i bibliotekave shkollore me libra duke u bazuar në kërkesat dhe pëlqimet e nxënësve. Disa nga pjesëmarrësit po ashtu shtuan se lexueshmëria si fenomen është ende prezente, mirëpo vetëm ka ndryshuar mënyra se si nxënësit lexojnë: tani ka edhe mjete tjera, përpos mjeteve klasike si librat. Ndërsa, një pjesëmarrëse gjykoi se lexueshmëria sot është në rënie, dhe citoi ngritjen e përdorimit të teknologjisë si shkaktare kryesore për këtë rënie.

“Gjeneratat [e mëhershme] me të vertëtë kemi lexuar shumë më shumë, kur kemi qenë ne nxënës, por megjithatë edhe atëherë edhe tash lexohet, edhe pse format ose mjetet me të cilat lexohet kanë ndryshuar. Gjeneratat tona i kemi pasur vetëm librin për të lexuar, gazetën... tani ka mjete teknologjike, faqe të ndryshme që munden të i shfrytëzojnë të rinjtë.” –

Psikolog shkollor

“Mendoj se në qoftëse biblioteka do të ishte më e pajisur, pak më atraktive për nxënës, niveli i lexueshmërisë do të ishte më mirë se që është tani.” –

Psikologe shkollore

Kategoria 2: Dallimet gjinore në të lexuar dhe shkaqet për këto dallime

Pjesëmarrësit dhanë mendimet e tyre lidhur me ekzistencën (apo jo) të dallimeve gjinore në fenomenin e të lexuarit. Pothuajse të gjithë të intervistuarit u pajtuan se janë vajzat ato që lexojnë më shumë sesa djemtë. Pos kësaj, kishte mendime të tilla që vajzat kujdesen më shumë që të përfundojnë referatet më zellshëm dhe të hulumtojnë më shumë edhe jashtë përmbajtjes së librave. Shkaktarët për këto dallime, pjesëmarrësit propozuan, janë disa faktorë biologjik dhe mjedisor. Faktori kyç që

shtyen djemtë të lexojnë më pak, psikologët menduan se është fakti që djemtë mirren më shumë me aktivitete fizike/sportive. Ndërsa, ata propozuan se vajzat lexojnë më shumë për shkak të aktivitetit sportiv më të vogël si dhe presionit nga familja që të jenë më të zellshme. Përpos dallimeve në shpeshësinë e të lexuarit, psikologët propozuan se ka dallime edhe në zhanret që lexohen, për shembull, djemtë kanë tendencë që më shumë të lexojnë libra thriller ose me përmbajtje kibernetike, ndërsa vajzat me përmbajtje më emocionale.

“Ndoshta vajzat japin më shumë përpjekje për të qenë të mira për nënën dhe babain e tyre. Mesiguri kjo i shtyen të jenë më të përkushtuara [në lexim].” – Psikologe shkollore

Kategoria 3: Ndërlidhja në mes të lexuarit dhe mirëqenies psikologjike

Të gjithë psikologët fuqimisht u pajtuan që të lexuarit ka një ndërlidhje të madhe me mirëqenien psikologjike të fëmijëve. Njëri nga pjesëmarrësit deklaroi që, përpos që të lexuarit ndikon në mirëqenien psikologjike momentale të fëmijëve, ndikon po ashtu edhe në zhvillimin e mëtutjeshëm të tyre. Pjesëmarrësit listuan një mori përfitimesh psikologjike nga të lexuarit: zhvillimi i aftësive sociale me bashkëmoshatarë; zhvillimi i stabilitetit emocional; përmirësimi i raporteve me kolegë dhe me prindër; ulja e sjelljeve anti-sociale; njohja më e thellë e vetes dhe kanalizimi më i duhur i aspiratave; përmirësimi i aftësive për zgjidhjen e problemeve; rritja e stabilitetit emocional si dhe zvogëlimi i stresit, ankthit, e tensionit. Ata dhanë edhe shembuj nga përvoja praktike ku nxënësit janë ndjerë dukshëm më mirë pas leximit të librave.

“Në momentin kur iu ka ofru një libër për ta lexuar, ajo ka vazhduar tërë vitin të marrë libra çdo dy javë në bibliotekën e shkollës, dhe mbas disa seancave ajo vetë është shprehura që i ka ndihmuar shumë pasi ajo ka qenë një personalitet që ka shpërthyer, më temperamente, ka krijuar situata konfliktuoze edhe brenda klasës, ka pasur pak shoqe dhe shokë por pastaj ka arritur të krijojë shoqëri më të gjerë, të reflektojë më ndryshe në

krahasim me gjeneratën e saj, ka arritur edhe t'i zbusë emocionet me prindërit të cilat kanë qenë shumë të acaruar gjatë kohës së adoleshencës.” – Psikologe shkollore

“...kështu që po, leximi ndikon në mirëqenie, edhe po mendoj që ata që janë të pjekur edhe emocionalisht, më stabil dhe tregojnë interesim më të madh në krahasim me ata që ende po luftojnë me gjetë çka iu pëlqen të bëjnë e çka s’iu pëlqen, ta gjejnë vendin e tyre brenda shoqërisë; patjetër që kanë lidhshmëri me njëra-tjetrën.” – Psikologe shkollore

Kategoria 4: Mekanizmat e ndikimit pozitiv që të lexuarit ka në mirëqenien psikologjike

Pjesë e argumenteve për mendimet e psikologëve ishin edhe shembujt praktik që ata dhanë. Nga përvoja e tyre, ata listuan disa raste në të cilat nxënësit janë ndjerë dukshëm më mirë pas leximit të librave. Mënyra se si libri ndihmon në rritje të mirëqenies psikologjike, psikologët mendojnë se ka të bëjë me faktin se libri është një mjet shumë konstruktiv i lirim të stresit e tensionit; ndërton shkathtësi jetësore të cilat iu ndihmojnë fëmijëve të menjanojnë konfliktet; dhe promovon sjellje adaptive. Pos kësaj, në libra fëmijët gjejnë figura me historitë jetësore të të cilave ata mund të bashkëndjenjë, sidomos gjatë periudhes interesante të adoleshencës.

“Një nxënës që lexon shumë është më komunikativ; kjo ia lehtëson qasjen e tij në raport me shkollën, me mësimdhënësit, me shokët dhe shoqet; ka njohuri më shumë, i njeh më mirë tipat e njerëzve, i njeh më shumë emocionet; di t’i kanalizojë, drejtojë mirë aspiratat e veta; di ose aftësohet për zgjedhjet e problemeve në jetë.” – Psikolog shkollor

Kategoria 5: Konteksti familjar si motivues apo demotivues për të lexuar

Të gjithë pjesëmarrët u pajtuan se konteksti familjar ka një ndikim madhor në formimin e shprehisë së të lexuarit në fëmijëri. Psikologët deklaruan se modelimi nga prindërit është një faktor kyç që shtyen fëmijët të lexojnë, sepse fëmijët kanë prirje të bëjnë çfarëdo që bëjnë prindërit e tyre. Përpos modelimit, edhe krijimi i një atmosfere

të përshtatshme të leximit është jetike për fëmijët. Për shembull, fëmijët me kushte ekonomike më të dobëta ndonjëherë kanë nevojë të punojnë për të sjellur të ardhura për familjen, rrjedhimisht nuk kanë kohë të lexojnë.

Një nga psikologët propozoi se duhet të promovohet shprehja e të lexuarit në mënyrë strikte, njejtë si shprehi të tjera si larja e dhëmbëve, rregullimi i shtratit, etj. – të cilat respektohen me përpikëri nga fëmijët. Më tutje, disa nga pjesëmarrësit treguan nga përvoja e tyre se fëmijët që shfaqin më së shumti ngecje në të mësuar kanë prindër me ngritje akademike jo shumë të lartë, duke propozuar se nga prindërit varet jo vetëm lexueshmëria në veçanti, por edhe arritja dhe suksesi i fëmijëve në përgjithësi.

“...edhe gjatë krejt viteve të shkollimit, ngecjet edhe shqetësimet, vështirësitë më së shumti paraqiten te nxënësit me prindër të paarsimuar. Fëmija modelon sjelljet e prindërve, ai/ajo duhet të shohë prindërit duke lexuar. Nëse nuk i sheh ata duke lexuar, nëse nuk ka kontakt, nëse nuk iu kanë krijuar kushtet, nëse në shtëpi ka fare pak ose nuk ka libra jashtëshkollore; atëherë nuk mund të kultivohet kultura e leximit.” – Psikologe shkollore

“Fëmijëve duhet t’u mësohet shprehja e leximit, njësoj si shprehitë e tjera; larja e dhëmbëve, rregullimi i shtratit.” – Psikolog shkollor

Kategoria 6: Angazhimi mental i fëmijëve gjatë leximit. A lexojnë fëmijët në mënyrë pasive apo aktive?

Psikologët dhanë mendime të ndryshme lidhur me angazhimin mental të fëmijëve gjatë leximit, mirëpo shumica u pajtuan se një përqindje e madhe e fëmijëve lexojnë në mënyrë pasive. Ata identifikuan faktorin e motivimit si faktor moderues në procesin e të lexuarit aktiv: nëse fëmijët pëlqejnë procesin e të lexuarit dhe librin që po lexojnë, ata do ta lexojnë atë në mënyrë aktive dhe kritike. Në të kundërtën, leximi i atij libri do të përceptohet vetëm si një obligim që duhet përmbushur. Prandaj, fëmijët duhet të lihen të zgjedhin vetë librat që dëshirojnë të lexojnë dhe procesi i të lexuarit të promovohet si një proces që në vetvete sjell kënaqësi.

Më tutje, psikologët identifikuan mësimdhënësit si bartës të shumicës së përgjegjësisë për mungesën e të lexuarit aktiv tek fëmijët. Mësimdhënësit kanë tendencë të kërkojnë informata teknike nga fëmijët duke çuar tek leximi mekanik (“përmendësh”) nga ana e fëmijëve, kur në fakt do të ishte më mirë të kërkonin informata më komplekse dhe mendime të lira nga nxënësit – psikologët mendojnë. Në fund, pjesëmarrësit deklaruan se përmbajtja më e shumëllojshme e librave mund të rrisë të lexuarit aktiv. Kur libri përmban figura e ilustrime të ndryshme, fëmijët mund të angazhohen më shumë në procesin e të lexuarit. Pos kësaj, edhe shpjegimi alternativ dhe kreativ i koncepteve nga mësimdhënësit mund të stimulojë të menduarit kritik tek fëmijët, rrjedhimisht duke bërë që fëmijët të mësojnë materialin thellësisht.

Kategoria 7: Inteligjenca emocionale dhe rëndësia e saj në kontekstin shkollor

Psikologët pjesëmarrës unanimitisht deklaruan se inteligjenca emocionale ka rëndësi të madhe në kontekstin shkollor, ndonëse menduan se nuk i ipet vëmendja e duhur. Sipas tyre, inteligjenca emocionale iu ndihmon fëmijëve të menaxhojnë edhe emocionet personale por edhe ato akademike, kështu duke i ndihmuar të jenë adaptiv në rrugëtimin shpeshherë të vështirë shkollor. Në veçanti, inteligjenca emocionale ndihmon në njohjen e vetes, marrëdhëniet më të mira me bashkëmoshatarë, si dhe rritje të vetëvlerësimit – tipare të cilat shihen si jetike për sukses personal dhe akademik.

“Inteligjenca emocionale ndikon në marrëdhëniet personale të nxënësve, në suksesin e tyre akademik, në vetëvlerësim në njohjen dhe menaxhimin e emocioneve.” – Psikologe shkollore

Kategoria 8: Biblioterapia si mjet për të reduktuar problemet emocionale

Një pakicë e pjesëmarrësve deklaruan se e kanë përdorur ndonjëherë terapinë e librit si mjet për të zvogëluar problemet emocionale gjatë seancave të tyre këshilluese me

fëmijë. Megjithatë, shumica e psikologëve deklaruan se përdorimi i biblioterapisë do të ishte mënyrë shumë e qëlluar për uljen shqetësimit emocional të fëmijëve. Një nga pjesëmarrësit nga përvoja e tij deklaroi se libri është një mjet i mirë edhe për krijimin e një raporti të shëndetshëm ndërpersonal në mes të psikologut/es dhe fëmijës.

Si pengesë në përdorimin e biblioterapisë në seancat këshilluese me fëmijë u identifikuan mungesa e motivimit të fëmijëve për të lexuar, si dhe gjendja e varfër e bibliotekave shkollore. Me furnizimin e bibliotekave shkollore me më shumë libra, psikologët shkollorë do të kenë mundësinë të referojnë libra tek nxënësit qoftë për të ulur shqetësimin e tyre psikologjik, qoftë për të ngritur kapacitetet e tyre, si p.sh. inteligjencën emocionale.

“Fëmijëve duhet t’u ndihmojmë përmes biblioterapisë; seanca grupore dhe individuale ku këshillojmë për çështje të ndyshme, me fokus librin.” –

Psikologe shkollore

Kategoria 9: Rekomandime për ngritjen e vetëdijes mbi përfitimet e të lexuarit

Rekomandimet e propozuara nga psikologët përfshijnë rekomandime në 3 fusha: rekomandime për familjet, për organizatat jo-qeveritare, si dhe për institucionet. Si pjesë e rekomandimeve familjare, psikologët deklaruan se është e nevojshme që prindërit të shërbejnë si model për fëmijët, si dhe të iu mundësohet atyre një kontekst optimal për të lexuar, p.sh. këndi i librave në shtëpi, kushtet ekonomike të mjaftueshme, etj. Më tutje, për organizatat jo-qeveritare u rekomandua që të fillojnë të mbajnë trajnime për ngritjen e inteligjencës emocionale, ndërsa organizatat që merren me kulturën e të lexuarit të organizojnë panaire dhe ngjarje të ndërlidhura me librin. Në fund janë edhe rekomandimet për institucionet, të cilat e përbëjnë pjesën më të madhe të rekomandimeve. Institucionet si Ministria e Arsimit dhe Shkencës si dhe shkolla individuale u rekomanduan që t’ua lënë në dorë nxënësve përzgjedhjen e librave që dëshirojnë t’i lexojnë dhe t’i kenë në bibliotekën shkollore; të fillojnë të

aplikojnë Biblioterapinë (seanca/takime grupore ku lexohen libra për qëllime terapeutike/këshilluese); të obligojnë leximin e librave edhe në lëndë tjera përpos Gjuhës Shqipe, si p.sh. në Edukatë Qytetare apo Histori; mësimdhënësit të promovojnë mendimin kritik tek nxënësit e të ulin të mësuarit mekanik; dhe të mbështeten më shumë hulumtime të cilat kanë për qëllim të orientojnë intervenime të ardhshme.

Diskutimi



Diskutimi

Studimet kanë treguar se libri ka efekt pozitiv tek fëmijët duke i ndihmuar ata që të zhvillojnë aftësi të ndryshme, ndër të tjera, të zhvillojnë inteligjencën emocionale (Schiller, 2009). Leximi për kënaqësi, po ashtu, u sjell fëmijëve përfitime të shumta duke kontribuar në arritjen dhe aftësinë e tyre në të lexuar (Cox & Guthrie, 2001), si dhe lidhet me shëndet më të mirë dhe kënaqësi të fortë me jetën. Prandaj, duke marrë parasysh rëndësinë dhe efektin që ka leximi tek fëmijët, si dhe mungesën e hulumtimeve në vendin tonë që nxjerrin në pah diçka të tillë, ky studim ka synuar të analizojë dhe kuptojë më thellë ndërlidhjen mes leximit, mirëqenies psikologjike dhe inteligjencës emocionale tek fëmijët në Kosovë.

Kështu, rezultatet e këtij studimi kanë treguar që motivimi i brendshëm për të lexuar ka shënuar mesatare më të lartë në të dyja, mirëqenien psikologjike dhe inteligjencën emocionale. Edhe studimet e tjera e mbështesin rritjen e motivimit të brendshëm për të lexuar përmes ofrimit të mundësisë që fëmijët të bëjnë vetë përzgjedhjen e librave, e cila ndikon po ashtu edhe në performancë më të mirë akademike (Flowerday & Scharw, 2000). Kur jemi tek përzgjedhja e librave, edhe psikologët pjesëmarrës në këtë studim, ndajnë të njëjtin mendim duke potencuar që nëse fëmijët zgjedhin vetë librat që dëshirojnë të lexojnë, atëherë do ta pëlqejnë librin dhe do ta lexojnë atë në mënyrë aktive dhe kritike, që rrjedhimisht ndikon në rritjen e nivelit të lexueshmërisë. Gjithashtu, zhanret të cilët zgjedhin nxënësit për të lexuar janë të një rëndësie të madhe, ku sipas të dhënave që kanë dalur nga ky studim, ka rezultuar se nxënësit të cilët lexojnë zhanret “Poezi” dhe “Biografi & Autobiografi” tregojnë pikë më të larta në mirëqenien psikologjike, ndërsa ata të cilët lexojnë zhanret “Western” dhe “Libra shkollorë” kanë treguar pikë më të larta në inteligjencë emocionale. Për më tepër, një studim nga Cox dhe Guthrie (2001) mbështetë të dhënat e lartëcekura duke treguar se leximi i pavarur ose leximi për kënaqësi u sjell fëmijëve përfitime në mënyra të shumta. Për shembull, numri i librave që fëmijët lexojnë për kënaqësi dhe për obligime

apo detyra shkollore është gjetur të jetë një kontribues kryesor në arritjen dhe aftësinë e tyre në të lexuar. Rezultatet në studimin aktual, po ashtu, tregojnë se pëlqyeshmëria e leximit nga ana e fëmijëve në Kosovë ka efekt në mirëqenien psikologjike, si dhe në inteligjencën emocionale. Ndërsa, në një studim nga Ferguson (2014) doli se leximi i librave mund t'i shtyjë fëmijët të ndihmojnë të tjerët dhe të kuptojnë vështirësitë që të tjerët mund të kalojnë. Në anën tjetër, leximi i librave fiktiv parashikon empatinë ndër fëmijë dhe adoleshentë (Mar, Oatley & Peterson, 2009).

Shpeshtësia dhe numri i librave të lexuar në këtë studim ka rezultuar të jetë e rëndësishme për mirëqenien psikologjike dhe inteligjencën emocionale të fëmijëve. Po kështu, e dhënë tjetër e rëndësishme e këtij studimi është se të lexuarit aktiv e parashikon në mënyrë të rëndësishme mirëqenien psikologjike dhe inteligjencën emocionale të fëmijëve. Për më shumë, psikologët pjesëmarrës kanë deklaruar se të lexuarit ndikon jo vetëm në mirëqenien psikologjike të fëmijëve, por ka edhe përfitime të tjera si: zhvillimi i aftësive sociale me bashkëmoshatarë, zhvillimi i stabilitetit emocional, ulja e sjelljeve anti-sociale, zvogëlimi i stresit dhe ankthit, njohja më e thellë e vetës, rritja e empatisë, etj. Duke marrë parasysh rëndësinë e inteligjencës emocionale, edhe studimet e tjera të shumta kanë vënë në pah nevojën që konteksti shkollor të ofrojë mundësi që dalin përtej obligimeve shkollore dhe të ofrohen hapësira për zhvillimin socio-emocional të fëmijëve, në mënyrë që të rriten aftësitë/kapacitetet e nxënësve për të menaxhuar në mënyrë të duhur emocionet (Roberts, 2009). Tutje, edhe psikologët pjesëmarrës në këtë studim kanë deklaruar unanimisht që inteligjenca emocionale ka rëndësi të madhe për menaxhimin e duhur të emocioneve personale po edhe atyre akademike që të iu ndihmojnë fëmijëve të jenë adaptiv, në veçanti përgjatë rrugëtimit të tyre shkollor.

Duke qenë se të lexuarit është një nga aktivitetet që më së shumti ndihmon në zhvillimin kognitiv dhe emocional të fëmijëve, edhe të dhënat e dala nga ky studim tregojnë për rëndësinë që ka leximi në zhvillimin e gjithëmbarrshëm të fëmijëve, me fokus në mirëqenien psikologjike dhe inteligjencën emocionale të tyre. Në mënyrë që

aktiviteti i leximit të bëhet shprehi në mesin e fëmijëve, ajo do të duhet të kultivohet tutje në mënyrë që të bëhet pjesë e fëmijëve edhe në fazat e mëvonshme të jetës. Fëmijët të cilët lexojnë gjatë kohës së lirë, përveç që kanë shëndet më të mirë dhe kënaqësi me jetën (Cox & Guthrie, 2001), ata gjithashtu bëhen lexues më të mirë, kanë performancë më të mirë akademike si dhe kanë njohuri përmbajtësore më shumë se sa ata që nuk lexojnë (Hughes-Hassell & Rodge, 2007).

Limitimet

Një ndër limitimet e këtij studimi është përdorimi i pyetësorve vetëraportues për mbledhjen e të dhënave, metodë kjo e cila si kufizim ka subjektivitetin e pjesëmarrësve gjatë dhënies së përgjigjeve. Mirëpo, për ta balancuar këtë kufizim, në këtë studim është përdorur edhe metoda kualitative, ku përmes intervistave me psikologë janë marrë informacione më të detajuara dhe perspektiva tjera janë marrur parasys.

Tjetër limitim i këtij studimi është administrimi online i pyetësorve, i cili mund të ketë ndikuar që mostra të mos jetë shumë përfaqësuese. Kështu, për të tejkaluar këtë limitim është tentuar, gjithsesi, që mostra të jetë sa më përfaqësuese, dhe prandaj pjesëmarrës në këtë studim kanë qenë nxënësit nga 68 shkolla të ndryshme fillore dhe të mesme të ulta, në 20 komuna të Kosovës.



Rekomandimet



Rekomandimet

Rekomandime për institucione & shkolla

- Nxënësve të iu ipet mundësia të zgjedhin librat që ata kanë për t'i lexuar, pasi që fëmijët lexojnë me më shumë zell librat që dëshirojnë, përkundër librave që iu imponohen;
- Të fillohet të aplikohet Biblioterapia (seanca grupore me lexim të librave) nëpër shkolla me psikologët shkollorë si udhëheqës, në mënyrë që të ngritet inteligjenca emocionale e fëmijëve si dhe të ulen shqetësimet e tyre psikologjike;
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës të punojë në ngritjen e kapaciteteve të psikologëve shkollorë në zhvillimin dhe aplikimin e biblioterapisë.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës të trajnojë mësimmhënësit që të nxisin të menduarit kritik tek fëmijët, duke mënjanuar pyetjet që kërkojnë përgjigje teknike, e duke përdorur pyetje që kërkojnë mendim të lirë dhe kompleks nga fëmijët;
- Mësimmhënësit të mësojnë nxënësit për të mësuarit aktiv, dhe të iu mësojnë atyre teknika të ndryshme si p.sh. mbajtja e shënimeve, nënvizimi i pjesëve të rëndësishme, etj;
- Institucionet relevante si Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndëtesisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të krijojnë ekipe të përbashkëta punuese për të adresuar çështje që ndërlidhen me mirëqenien e përgjithshme psikologjike të fëmijëve në institucionet edukativo-arsimore. E njëjta do duhej të aplikohet edhe ndër institucionet e nivelit lokal.
- Psikologët e shkollave të fillojnë të referojnë librin si mjet terapeutik në seanca një-me-një me fëmijë apo edhe në grup;
- Të mbështesin më shumë hulumtime të cilat do të mund të përdoren për të drejtuar intervenime të ardhshme;

- Të pasurohen bibliotekat shkollore me libra sipas kërkesës së fëmijëve;
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës të investojë që librat shkollorë të përmbajnë informata në forma të ndryshme: informatat tekstuale të shoqërohen me ilustrime atraktive që nxisin interesim tek fëmijët dhe shpjen që ata të kuptojnë më thellësisht informacionin.

Rekomandime për organizata jo-qeveritare

- Të organizojnë trajnime për vetëdijësimin e individëve lidhur me rëndësinë e inteligjencës emocionale;
- Të organizojnë ngjarje që promovojnë kulturën e të lexuarit;
- Të hartojnë hulumtime për të kuptuar më shumë rreth marrëdhënieve në mes të të lexuarit, mirëqenies psikologjike dhe inteligjencës emocionale.

Rekomandime për familje

- Të kultivohet shprehia e të lexuarit tek fëmijët qysh në moshë të re, duke bërë këto veprime: prindërit të lexojnë libra në mënyrë që përmes modelimit, fëmijët të mësojnë të lexojnë; të iu blihen librat si dhurata fëmijëve, etj;
- Të nxiten fëmijët të lexojnë në mënyrë të vazhdueshme, që të maksimizohet efekti pozitiv i librave në mirëqenien psikologjike dhe inteligjencën emocionale të fëmijëve;
- Prindërit të investojnë që të krijohet një kënd i caktuar me libra në shtëpi, dhe ai kënd të pajiset me libra sipas preferencës së fëmijëve;
- Pjesë e komunikimit prindër-fëmijë të jenë edhe diskutimet lidhur me libra: përmbajtja e tyre; pjesët e preferuara dhe më pak të preferuara të tyre; konfliktet në atë libër; etj.



Referencat



Referencat

- Alidemaj, A., & Sijarina, L. (2019). Lexueshmëria në shkollat e mesme të ulta të Prishtinës. *ETEA*.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2018). "Statistikat e Kulturës 2018". Marrë nga <https://ask.rks-gov.net/media/5132/statistikat-e-kultures-2018.pdf>
- Baker, L., & Wigfield, A. (1999). Dimensions of children's motivation for reading and
- Bryant, C. (2007). "The Relationship Between Emotional Intelligence and Reading Comprehension in High School Students with Learning Disabilities". Dissertations. 250. <https://digitalcommons.andrews.edu/dissertations/250>
- Chettri, K. & Rout, S. K. (2013). Reading Habits – An Overview. Marrë më 30 Qeshor, 2020. <http://www.iosrjournals.org/iosr-jhss/papers/Vol14-issue6/C01461317.pdf?id=6700>
- Ciarrochi, J., Chan, A. Y., & Bajgar, J. (2001). Measuring emotional intelligence in adolescents. *Personality and Individual Differences*, 31(7), 1105-1119.
- Clark, C and De Zoysa, S. (2011). Mapping the interrelationships of reading enjoyment, attitudes, behaviour and attainment: An exploratory investigation. London: National Literacy Trust.
- Cox, K.E. and Guthrie, J.T. (2001). Motivational and cognitive contributions to students' amount of reading. *Contemporary Educational Psychology*, 26(1), 116-131.
- Cunningham, A.E. and Stanovich, K.E. (1997). Early reading acquisition and its relation to reading experience and ability ten years later. *Developmental Psychology*, 33 (6), 934- 945.
- Cunningham, A.E. and Stanovich, K.E. (1998). What reading does for the mind. *American Educator*, 22(1,2), 8-15.
- Davoudi, M., Nafchi, M.A., Khodabakhshi, M. (2015). The Relationship between Emotional Intelligence and the Choice of Reading Strategies of Iranian EFL Learners. *Journal of Literature, Languages and Linguistics*, (17).
- Deci, E., Vallerand, R., Pelletier, L., & Ryan, R. (1991). Motivation and education: The self-determination perspective. *Educational Psychologist*, 26(3), 325–346.

- Ferguson, C. J. (2014). Is reading “banned” books associated with behavior problems in young readers? The influence of controversial young adult books on the psychological well-being of adolescents. *Psychology of Aesthetics, Creativity, and the Arts*, 8(3), 354–362. <https://doi.org/10.1037/a0035601>
- Elley, W.B. (1992). How in the world do students read? Hamburg: International Association for the Evaluation of Education Achievement.
- Ghalebardi, G.S & Noorhidawati, A. (2017). Engaging Children with Pleasure Reading: The E-Reading Experience. *Journal of Educational Computing Research* 0 (0) 1-25. <https://doi.org/10.1177/0735633117738716>
- Goleman, D. (1995a). Emotional intelligence. New York: Bantam Books.
- Gottfried, A. E. (1990). Academic intrinsic motivation in young elementary school children. *Journal of Educational Psychology*, 82, 525–538.
- Graczyk, P., Weissberg, R., Payton, J., Elias, M., Greenberg, M., & Zins, J. (2000). Criteria for evaluating the quality of school-based social and emotional learning programs. In R. P. Bar-On & J. D. A. Parker (Eds.), *The handbook of emotional intelligence: Theory, development, assessment, and application at home, school, and in the workplace* (pp. 391-410). San Francisco: Jossey-Bass.
- Hughes-Hassell, S. & Rodge, P. (2007). The Leisure Reading Habits of Urban Adolescents. <https://doi.org/10.1598/JAAL.51.1.3>
- Hill Strategies (2013). The Arts and Individual Well-Being in Canada: Connections between Cultural Activities and Health, Volunteering, Satisfaction with Life, and Other Social Indicators. Marrë nga https://hillstrategies.com/wp-content/uploads/2013/01/Arts_well_being2010_ExecSumm_0.pdf
- Howard, V. (2011). The importance of pleasure reading in the lives of young teens: Self-identification, self-construction and self-awareness. *Journal of Librarianship and Information Science*, 43(1), 46- 55. doi:10.1177/0961000610390992

- Lau, K., & Chan, D. W. (2003). Reading strategy use and motivation among Chinese good and poor readers in Hong Kong. *Journal of Research in Reading, 26*(2), 177–190.
- Lopes, P. N., Salovey, P., & Straus, R. (2003). Emotional intelligence, personality, and the perceived quality of social relationships. *Personality and Individual Differences, 35*(3), 641-658.
- Mar, R & Oatley, K. (2006). "The function of fiction in the abstraction and simulation of social experience." *Perspectives on Psychological Science, 3*(3), 173-192.
<http://www.yorku.ca/mar/papers.html>
- Mar, R., Oatley, K, & Peterson, J. (2009). Exploring the link between reading fiction and empathy. *Communications, 34*, 407- 428.
- Massimi, M., Campigotto, R., Attarwala, A., & Baecker, R. M. (2013). Reading together as a leisure activity: Implications for e-reading.
- OECD (2002). Reading for change: Performance and engagement across countries. Results from PISA 2000. New York: Organisation for Economic Cooperation and Development.
- Palmer, B., Donaldson, C., & Stough, C. (2002). Emotional intelligence and life satisfaction. *Personality and individual differences, 33*(7), 1091-1100.
- Raghavan, N. & Panboli, S. (2018). Measuring Emotional Intelligence of School Children – A Pilot. *International Journal of Research in Humanities, Arts and Literature, 6* (1), 207-218.
- Roberts, R.C. (2009). Emotional consciousness and personal relationships. *Emotion Review, 1*(3), 281-288.
- Ryan, R. M., & Deci, E. L. (2000). Intrinsic and extrinsic motivations: Classic definitions and new directions. *Contemporary Educational Psychology, 25*, 54–67.
- Saklofske, D. H., Austin, E. J., & Minski, P. S. (2003). Factor structure and validity of a trait emotional intelligence measure. *Personality and Individual Differences, 34*(4), 707-721.
- Schiller, P. (2009). Seven skills for school success: Activities to develop social and emotional intelligence in young children. Beltsville, MD: Gryphon House.

- Skinner, E. A., Kindermann, T. A., & Furrer, C. J. (2008). A motivational perspective on engagement and disaffection: Conceptualization and assessment of children's behavioral and emotional participation in academic activities in the classroom. *Educational and Psychological Measurement, 69*(3), 493–525. <https://doi.org/10.1177/0013164408323233>
- Taboada, A., Tonks, S. M., Wigfield, A., & Guthrie, J. T. (2009). Effects of Motivational and Cognitive Variables on Reading Comprehension. *Reading and Writing, 22*, 85-106.
- Thomson, I. (1987). Understanding teenager reading. Reading Processes and the Teaching of Literature. Melbourne: Methuen & Co.
- Howard, V. (2013). "The Importance of Pleasure Reading: Self-identification, self-construction and self-awareness. University of Dalhousie
<http://brbell.blogs.sd73.bc.ca/files/2013/03/Importance-of-Pleasure-Reading.pdf>
- Wang, J., & Guthrie, J. T. (2004). Modeling the effects of intrinsic motivation, extrinsic motivation, amount of reading, and past reading achievement on text comprehension between U.S and Chinese students. *Reading Research Quarterly, 39*(2), 162–186.
- Wang, J., & Guthrie, J. T. (2004). Modeling the effects of intrinsic motivation, extrinsic motivation, amount of reading, and past reading achievement on text comprehension between U.S. and Chinese students. *Reading Research Quarterly, 39*(2), 162–186.
- Wigfield, A., Guthrie, J. T., Perencevich, K. C., Barber, A. T., Klauda, S. L., McRae, A., & Barbosa, P. (2008). Role of reading engagement in mediating effects of reading comprehension instruction on reading outcomes. *Psychology in the Schools, 45*(5), 432–445. Marrë nga <https://doi.org/10.1002/pits>
- Wigfield, A., Guthrie, J. T., Tonks, S., & Perencevich, K. C. (2004). Children's motivation for reading: Domain specificity and instructional influences. *The Journal of Educational Research, 97*, 299–310.

Mirënjohje

Organizata jo-qeveritare ETEA, Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore (QHPSM) dhe Qendra për Afirmin Social të të Rinjve (CSAY) falënderojnë Forumin për Iniciava Qytetare (FIQ), INDEP dhe Zyrën e BE-së në Kosovë për përkrahjen financiare të projektit “Ndikimi i leximit aktiv në shëndetin mendor të fëmijëve” që rezultoi me publikimin e këtij raporti hulumtues.

Për mbështetjen e tyre financiare falënderojmë edhe Komunën e Prishtinës, Translation Center dhe Smart Center, të cilat me donacionet e tyre siguruan implementimin e suksesshëm të projektit.

Po ashtu, ETEA, QHPSM & CSAY falënderojnë të gjithë akterët e përfshirë në hulumtim, veçanërisht nxënësit dhe psikologët shkollorë që ishin pjesëmarrës të hulumtimit, si dhe mësimdhënësit të cilët lehtësuan qasjen e ekipit hulumtues ndaj pjesëmarrësve. Si dhe, organizata TOKA, The Ideas Partnership, dhe Klubi i Super-Vullnetarëve Nova për ndihmën me shpërndarjen e pyetësorit.

Për punën e mirë dhe profesionale, koalicioni i organizatave falënderon gjithë ekipin e projektit në fjalë, duke filluar nga autorët (sipas renditjes alfabetike) Diar Hajrizi, Drenusha Bujari, Fatime Rrahmani, Shkurtë Bajgora dhe Zoran Stankovic.

Veçanërisht, koalicioni i organizatave falënderon shqyrtuesit e brendshëm të raportit Besnik Peci dhe Liridona Sijarina.

Faleminderit!

